

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7712 E shtunë 17 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në 'Deutsche Welle'
Në një intervistë për 'DW', Peter Beyer, raportues i grupit parlamentar CDU/CSU për Kosovën dhe Serbinë në Komisionin e Jashtëm të Bundestagut, thotë se nuk do...

S'ka anëtarësim të Serbisë në BE, pa njohur më parë Kosovën



Opinion i Ditës
Ambasadori i ri i BE në Tiranë, Luixhi Soreka, ka dalë këtë javë në 'Opinion', duke prezantuar një profil të ri të postit që ai drejton. Ndryshe nga 3 vitet e drejtuara nga...

A po "shikon" Europa më mirë me ambasadorin e ri?



5700 emrat/ Kush merr dëmshpërblimin

Lista, dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit ish-të përndjekur

Lista e shtatë/ Ministria e Financave: 3 muaj afat për plotësimin e dokumenteve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që Rpresin të marrin kështu e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Behet fjalë për përfitues të kategorisë joparësore që do të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë...

Në faqen 10-11

PRESIDENTI I HEQ GRADEN GJENERAL, PRANON PROPOZIMIN E RAMES

DEKRETI I METES, LLESHAJ MINISTER I BRENDSHEM

Kreu i shtetit i jep "OK" pasardhësit të Fatmir Xhafajt. Rama: Kur ka vullnet të mirë, gjithçka zgjidhet. Basha: Peshku, i qelbur nga koka



(Në foto) Presidenti Ilir Meta. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj



Në faqen 3

DEBATI NE KESHILL

Skema e PS për të zhblokuar punën e Kuvendit pas bojkotit të opozitës

Në faqen 2

EMISIONI I BAMIRESISE

Rama në 'News 24': Sfida e mbylljes së lotove sportive dhe kazinove më 2019

Në faqen 4

ELBASAN

Shpërthim me granatë në lokal, plagoset rëndë pronari 32-vjeçar

Në faqen 7

FLET AUTORI

Kadare: Libri i ri, grindja e Stalinit me Pasternakun dhe 1 shekull mister

Në faqen 12

VIZITA NE UNIVERSITET



"Luarasi" pret mitin e librarëve në Itali, Ruka: Hapat e para të bashkëpunimit

Në faqen 9

BLUE TOOTH

U! fustanin para pasqyrës, Aurela Hoxha provokon duke nxjerrë gjoks. Pse Arilena Ara shpërthu në lot gjatë emisionit

Misi shqiptar pozon nudo në bregdetin e Vlorës

Fituesja e 'Mis Grand Albania', Dashuria Bilaj: Pse e mora këtë vendim

Nga ENRIK MEHMETI

Dashuria Bilaj është një artiste shqiptare që karrierën dhe jetën e ka ndërtuar në Kosovë. Prej vitesh është në tregun muzikor ndërsa këtë vit ajo ka fituar çmimin 'Miss Grand Albania'. Bilaj është rikthyer në Shqipëri për të



dhënë një mesazh të fortë në lidhje me një çështje, e cila ka qenë gjatë gjithë kohës jo vetëm shqetësim për Shqipërinë, por edhe vendet fqinje. Këngëtarja ka zgjedhur që të ngrejë shqetësimin e ndotjes së bregdetit duke kërkuar të tërheqë vëmendjen...

Suplement

PËRPLASJA DEKRETI

Zbardhet debati në Konferencën e Kryetarëve, PS kalon te "Ligjet" diskutimin për Rregulloren

Procesverbali, ja mekanizmi i PS për të shmangur bojkotin e PD

"Kjo punë nuk mund të bëhet vetëm nga dy apo tre veta"

Prej më shumë se 3 muajsh mazhorancës së majtë i është dashur të menaxhojë funksionimin normal të Kuvendit, në kushtet e bojkotit të opozitës. Deri tani ia ka dalë ta bëjë këtë me sukses në të gjitha komisionet parlamentare dhe në seancën plenare ku ka shumicën e nevojshme të anëtarëve, por ka hasur në vështirësi në ato struktura të Kuvendit ku si shumica e matë ashtu edhe opozita kanë përfaqësim të barabartë. Një prej tyre është edhe Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ku PS ka përfaqësim të barabartë me opozitën, secila me nga 5 anëtarë. Në këtë këshill mazhoranca po has probleme pasi nuk mund të mbledhet dhe të zhvillojë mbledhjet normale dhe mbi të gjitha të marrë vendime pasi nuk bën dot shumicën e nevojshme. Kjo problematikë është evidentuar gjatë mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 30 tetor, ku dhe është diskutuar mbi nevojën e miratimit të ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit. Në procesverbalin që është publikuar në faqen e Kuvendit në internet, është deputetja Vasilika Hysi ajo që ngre këtë shtetësim, duke theksuar se për shkak se nuk kishin anëtarë të mjaftueshëm, nuk mund të përfundonin punën enisur me ndryshimin e Rregulloreve. Ndaj ajo ka sugjeruar në këtë mbledhje që diskutimi i Rregulloreve t'i kalojë Komisionit të Ligjeve. Kjo zgjidhje është kundërshtuar fillimisht nga Kryetari i Kuvendit dhe kryetari i grupit parlamentar socialist, të cilët kanë bërë të qartë se ky atribut i takon Këshillit të Mandateve. Por pasi i është sqaruar edhe nga juristët e Kuvendit të pranishëm në këtë mbledhje ngërçi i numrave që vjen për shkak të bojkotit të opozitës, atëherë edhe Ruçi dhe Balla kanë rënë dakord që diskutimi i këtyre ndryshimeve t'i kalojë Komisionit të Ligjeve. Një manovër kjo për të shmangur vështirësitë që vijnë për shkak të bojkotit të PD-së.

DISKUTIMET
Vasilika Hysi - Në pikën 17 të kalendarit të Kuvendit është projektvendimi "Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregulloreve së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar. Stafi i Kuvendit dhe grupi i punës i ngritur në



Gjatë një mbledhjeje të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

bazë të detyrës që Ju kishit lënë në mbledhjen për Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ka depozituar një numër të konsiderueshëm ndryshimesh në Rregulloren e Kuvendit. Aktualisht kemi marrë propozimet e opozitës, të paraqitura që në momentin që është diskutuar "Kodi i Sjelljes". Stafi i Kuvendit, njëkohësisht projekti IPA dhe të gjitha rekomandimet e bëra, në kuadër të punës që kanë bërë stafi i Kuvendit me projektin IPA, janë pasqyruar. Materiali i është shpërndarë të gjithë deputetëve dhe është lënë afati në datën 2 nëntor për të sjellë mendime dhe sugjerime. Unë do sugjeroja, meqenëse numri i ndryshimeve është i konsiderueshëm dhe kërkon një punë profesionale, të cilën nuk mund ta bëjë vetëm unë dhe kolegu Bushati, pasi kolegët e opozitës që janë në grupin e punës, qoftë z. Mima, z. Haxhinasto, z. Alibeaj nuk janë të pranishëm, t'i kalojë për shqyrtim Komisionit të Ligjeve, për t'u parë një e nga një përpara se të kalojë në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Taulant Balla - Zoti Kryetari, e mirëkuptoj zonjën Hysi

për nevojën e një grupi më të zgjeruar. Grupi mund të plotësohet me deputetë të tjerë. Në fund të fundit ky është një vendim që i takon Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Nga Komisioni i Ligjeve mund të përzgjidhen dhe dy apo tre anëtarë të tjerë, të cilët mund t'i bashkohen këtij grupi dhe puna le të vijojë.

Vasilika Hysi - Kjo punë mendoj se nuk mund të bëhet vetëm nga dy apo tre vetë, aty ka dispozita që lidhen edhe me Komisionin e Ekonomisë edhe me Komisionin e Ligjeve. Mendoj që duhet të jetë një grup pune më i madh dhe të ketë një angazhim nga të gjithë kolegët. Unë prandaj sugjeroja për të kaluar në Komisionin e Ligjeve dhe nuk mund të jetë produkt i punës së dy apo tre apo pesë deputetëve.

Gramoz Ruçi - Si zgjidhet tani, pasi ky është atribut i Këshillit të Rregulloreve, Mandatet dhe Imunitetit?

Mimoza Pano - Nga praktika e derisotme parlamentare për ndryshimet në Rregulloren, ka praktika me të dy rastet. Rregullorja aktuale që ne kemi, e miratuar në vitin 2004, ka qenë objekt shqyrtimi

mi në komisionin e Ligjeve dhe ndryshimet e mëtejshme, jo në të gjitha rastet, por në pjesën më të madhe të rasteve i janë nënshtruar shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve. Pra, vërtetë është atribut i Këshillit të Rregulloreve, Mandatet dhe Imunitetit, por në kohën që ky Këshill është me 5 anëtarë dhe nuk mund të dalë me një raport apo shqyrtim të pjesshëm, sepse kemi referencën që Këshilli mbledhet si komisionet, kjo përbën një pengesë të madhe dhe e bllokun punën e këtij organi. Pra, duhet të jenë 6 veta që të mbledhet Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe në këto kushte, shqyrtimi nga një organ tjetër i Kuvendit që është Komisioni i Ligjeve i jep legjitimitet procesit.

Taulant Balla - Dakord do ta shqyrtoj Komisioni i Ligjeve. Komisioni Ligjeve të bëjë një axhendë dhe ta përfundojnë në kohën e duhur.

Ulsi Manja - Pyetje kisha! Komisioni i Ligjeve do të marrë në shqyrtim këto ndryshime që propozohen në Rregulloren meqenëse nuk funksionon Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin apo ka praktikë parlamentare për këtë gjë?

Mimoza Pano - Kur ndryshimet në Rregulloren kanë kaluar në Komisionin e Ligjeve i ka shqyrtuar vetëm Komisioni i Ligjeve, kur kanë kaluar në Këshillin për Rregulloren, i ka parë vetëm Këshilli. Për shembull, ndryshimet procedurale për rishikimin e Kushtetutës, neni 77/a dhe 77/b, që janë përfshirë në Rregulloren kanë kaluar vetëm në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Pra, ka praktikë parlamentare me të dy rastet.

Gramoz Ruçi - Si bëhet tani që kjo praktikë ka nisur në atë Këshill?

Mimoza Pano - Kryetari, është Konferenca e Kryetarëve që vlerëson dhe cakton komisionin përgjegjës që duhet ta shqyrtojë.

Gramoz Ruçi - Qartë.



Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

JURISTJA

"Vërtetë është atribut i Këshillit të Rregulloreve, Mandatet dhe Imunitetit, por në kohën që ky Këshill është me 5 anëtarë dhe nuk mund të dalë me një raport apo shqyrtim të pjesshëm, sepse kemi referencën që Këshilli mbledhet si komisionet, kjo përbën një pengesë të madhe dhe e bllokun punën e këtij organi. Pra, duhet të jenë 6 veta që të mbledhet Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin"



Kjo strukturë duhet të ketë përfaqësim të barabartë

Rregullorja, Këshilli funksionon kur marrin pjesë më shumë 5 anëtarë

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të bërë nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendit, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Këshilli kryesohet nga Kryetari i Kuvendit dhe studion propozimet për ndryshimin e Rregulloreve, jep mendime për çështje të interpretimit të Rregulloreve, si dhe për konfliktet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve të Kuvendit. Me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit, Këshilli shqyrton kërkesën për dhënie e autorizimit nga Kuvendi për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti, në përputhje me nenin 118 të Rregulloreve dhe nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të ndaluar ose të arrestuar, sipas nenit 119 të Rregulloreve. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Këshilli verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Këshilli aktual përbëhet nga 5 anëtarë të mazhorancës, dhe më konkretisht: Gramoz Ruçi, Klotilda Bushka, Bledar Çuçi, Vasilika Hysi dhe Ulsi Manja, ndërsa PD përfaqësohet me Gent Strazimirin, Enkelejd Alibeajn, Astrit Veliajn, Nasip Naçon dhe Dhurata Çupin. Këshilli i zhvillon mbledhjet kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Në kushtet kur 5 anëtarë e opozitës nuk janë të pranishëm, atëherë funksionimi i tij është i pamundur.



Dekretimi, Rama: Edhe kur krisjet janë të pariparueshme, ka rrugëzgjdhje

'Ngërçi', Meta dekretion Sandër Lleshajn ministër të Brendshëm

Presidenti: Arsyet përse e vonova firmën time

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dekretoi mbrëmë Sandër Lleshajn ministër të Brendshëm. Dekretimi u firmos në limitet e fundit të afatit kohor, tri orë para skadimit të tij. Kjo ishte hera e dytë që emri i Sandër Lleshajt qëndronte në tavolinën e Metës për dekretim, pasi herën e parë e refuzoi. Më herët gjatë ditës së djeshme, Meta dekretoi nxjerrjen në lirim të oficerit me gradë madhore, gjeneral brigade, Sandër Lleshaj, duke i hapur kështu rrugën dekretimit të tij në postin e ministrit. Presidenti konfirmoi zyrtarisht se ishte pikërisht statusi i tij si ushtarak aktiv, që e detyronte të mos e dekretonte si ministër, për shkak të kufizimeve që Kushtetuta ka për këtë kategori. Dekretimi i Lleshajt vjen përpara përfundimit të afatit kushtetues 7-ditor, për t'u shprehur për propozimin e dytë të kryeministrit Edi Rama, për emërimin e Sandër Lleshajt. Vendimi për dekretim erdhi pas më shumë se dy javësh debate mes dy institucioneve, Kryeministrit dhe Presidentit. Pas kësaj procedurë, Sandër Lleshaj do të bëjë betimin në Parlament. Presidenti Ilir Meta sqaroi mbrëmë në studion e emisionit "Zonë e Lirë" se përse vendosi të dekretonte Sandër Lleshajn në postin e ministrit të Brendshëm dhe nuk e bëri javën e shkuar këtë gjë. Presidenti bëri të ditur se vetëm ditën e enjte i ka ardhur kërkesa nga ana e ministres së Mbrojtjes, e cila i propozonte lirin nga detyra të gjeneral Sandër Lleshit. Sipas tij, pas lirim-it, Lleshit i hapet rruga për t'u dekretuar ministër. "Dje (të enjten) kam gjetur shkresën zyrtare të ministres së Mbrojtjes, e cila kishte bërë propozimin për lirin nga detyra si gjeneral. Nëse do ma kishin sjellë këtë



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

EMËRIMI
Sandër Lleshaj u emërua zëvendësministër i Brendshëm, pasi nuk u dekretua herën e parë nga Meta, ndërsa presidenti pranoi ripropozimin e dytë të kryeministrit Rama për të dekretuar zotin Lleshaj si ministër të Brendshëm.

"Peshku është qelbur nga koka"

Basha: Me a pa Llesh, Ministria e Brendshme ka shkuar për drej

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, reagoi dje ashpër pas dekretimit të Presidentit Meta për Sandër Lleshajn. Ai shprehet se Ministria e Brendshme ka shkuar për drej. "Me a pa Llesh, MB ka shkuar për drej sa kohë kryeministër është ai që mbron me thonj kriminelët dhe politikanët e lidhur me krimin, nga Dako të Balla, nga Tahiri e Xhafajt të Gjilkurri, Rrahja, Çyrbja e Sejdimi me shokë. Peshku është qelbur nga koka. Nga koka duhet pastruar!", shkruan Basha në "Facebook". Kurse kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, shprehet se kryeministri Edi Rama ka shkëlur Kushtetutën duke emëruar gjeneralin Sandër Lleshaj si z.vministër të Brendshëm dhe për këtë do mbajë përgjegjësi ligjore. "Kryeministri e ka shkëlur Kushtetutën, e ka shpërdoruar detyrën e ka nëpërkëmbur ligjin ndaj do të përgjigjet pa asnjë diskutim ligjor për këtë. Tanimë ky kryeministër ka kaluar dhunshëm vijën e kuqe të detyrimit të zbatimit të Kushtetutës dhe ligjit", - theksoi z. Vasili.

"Nga kush ruhet Lleshaj?",

Berisha: Policia blindon Elbasanin

Sh-kryeministri Sali Berisha postoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, sipas të cilit Elbasani është blinduar, sepse ka shkuar z.vministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj. "Bllokohen rrugët kur lëviz Lleshaj (Lleshaj) i Kallam Dëshatikut! Përforcimet me mijëra policë për vizitën e djeshme të z.vministrit të parë antikushtetues, antiligjor Lleshaj (Lleshaj) në Elbasan", shprehet z. Berisha. Më tej, ai zbardh mesazhin e qytetarit dixhital: "Elbasani, i blinduar nëpër rrugë. Gjatë gjithë rrugës Tiranë-Elbasan, sidomos në qytet, qindra e qindra policë. Merrret vesh se në orën 15 ka mbërritur me eskortë të përforcuar makina e z.vministrit të Brendshëm = ministër në Drejtorin e Policisë sikur udhëtonë në një zonë të pushtuar nga krimi. Mbarimi i takimit, po ashtu me shumë përforcime sa rruga e Metalurgjisë ishte bllokuar. Lind pyetja përse? Nga kush ruhet z.vministri i Rendit? Po qytetarët shqiptarë kush i ruan? A nuk janë edhe ata bij nënash? Zoti na ruajt!".

Takimi që i parapriu zgjidhjes finale

Pasi nxori në lirim Lleshajn, Meta takohet me Ruçin

Pasi Presidenti Ilir Meta dekretoi nxjerrjen në lirim të oficerit me gradë madhore, gjeneral brigade Sandër Lleshaj, vendim ky që i hap rrugë dekretimit të tij si ministër i Brendshëm, kreu i shtetit takoi dje kryeparlamentarin Gramoz Ruçi. Për afro 30 minuta, ata biseduan "kokë më kokë" në ambientet e Tirana. Në katin e tretë të hotel "Tirana International", biseda mes Ruçit dhe Metës mësohet se do i shërbeu gjetjes së një zgjidhjeje përfundimtare për postin e ministrit të Brendshëm. Të dy konsumuan një kafe, e cila ka



Presidenti Ilir Meta dhe kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

zgjatur 30 minuta, ndërsa punonjësit e Gardës mbajtën larg medien. Kujtojmë kryeministri Rama dërgoi për herë

të dytë në Presidencë emrin e Sandër Lleshit, për dekretimin e tij si ministër i Brendshëm.

kërkesë që më parë, do ta kisha dekretuar. Ky është një arsye e madhe, është arsye kushtetuese", deklaroi Meta.

REAGIMI

Kryeministri Edi Rama reagoi menjëherë pasi Presidenti Ilir Meta dekretoi Sandër Lleshajn si ministër të Brendshëm. Në një status në "Twitter", Rama shkruan se ky është një shembull kuptimplotë i faktit se edhe kur duket sikur krisjet janë

të pariparueshme a thyerjet të pashmangshme, ka gjithmonë një rrugëzgjdhje, nëse ka vullnet të mirë. "Dekretimi i Sandër Lleshajt ministër i Brendshëm, një shembull kuptimplotë i faktit se edhe kur duket sikur krisjet janë të pariparueshme a thyerjet të pashmangshme, ka gjithmonë një rrugëzgjdhje nëse ka vullnet të mirë. Ministri i ri, njeriu i duhur në vendin dhe kohën e duhur", shprehet z.Rama. Tashmë i preferuari i kryeministrit Rama do të jetë edhe zyrtarisht në krye të Ministrisë së Brendshme, pas votimit në Kuvend dhe betimit në Presidencë. Statusi i ushtarakut aktiv të Lleshajt ishte edhe pengesa kushtetuese për mosdekretimin e emrit të tij si min-

istër nga Presidenti Ilir Meta. Vetë kreu i shtetit i pati konsideruar si problematikë themelore kushtetuese propozimin për Lleshajn, për shkak të statusit të ushtarakut aktiv. Ndërsa pas zhdekretimit si ushtarak aktiv e firmosi emërimin e dekretit si ministër i Brendshëm. Sandër Lleshaj u propozua ministër i Brendshëm nga kryeministri Edi Rama në datën 27 tetor, pas dorëheqjes së papritur të Fatmir Xhafajt nga ky post. Pas mosdekretimit nga ana e Presidentit, kryeministri Rama e emëroi Sandër Lleshajn z.vministër, por me kompetencat e ministrit. Tani zyrtarisht, Sandër Lleshaj do të mbajë postin e ministrit të Brendshëm.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.11.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbartore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 057 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Sipall ankandin e tretë për pasurinë e paluashtme të dorëzuarit: Baltjar Alush Murto:

"Trull - Ndërtesë" me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 907 200 (nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Shitje me Ankand të tretë nga Studio Përmbartore L.D.C

-1. "Ndërtesë", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, faqe 83, ndodhur në Zonën kadastrale 3426 me adresë në Tulline, Tiranë. Regjistruar në Zyrën Vendore Regjistrimit Pasurive Paluashtme Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 lekë.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16:00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Përmbartore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

NISMA E QEVERISË RRËFIMI

Kryeministri flet për nismën e qeverisë në emisionin "Shqiptarët për shqiptarët"

Bixhozi, Rama: Momenti im i keq, kur mbeta vetëm me Braçen

"Lojërat e fatit janë çmenduri, duhet t'i ndalojmë"

Në studion e shqiptarëve ishte ftuar këtë të premte kryeministri Edi Rama, i cili foli pikërisht për fenomenin e bixhozit dhe nismën e qeverisë për t'i vënë kycin në 31 dhjetor të këtij viti. Emisioni u ndal pikërisht në këtë plagë të shoqërisë, teksa kryeministri foli në studio hapur, ku ndër të tjera tregoi edhe arsyet se si vendosi për të mbyllur përfundimisht lojërat e fatit dhe bastet. Kryeministri i nisi me një batutë me t'u akomoduar në studio: "Shyqyr që në këtë studio nuk të bërtasin ata që të ftojnë. Faleminderit për ftesën, pashë në prapaskenë historinë për varësinë e bixhozit. Zbatimi i ligjit është një sfidë e jashtëzakonshme. Bixhozi ishte i paligjshëm edhe në periudhën e komunizmit dhe dënohet me burg. Në 1989 ishin 200 raste të paligjshme", tha Rama. Kryeministri u shpreh se ajo që ishte më shqetësuese është se ky fenomen është jo vetëm shumë i përhapur, por edhe i lidhur me burimet kriminale të financimit. "Unë e kam deklaruar këtë sfidë qysh në ditën e fitores së



Rama: Sfidë edhe akti Kryeministri Edi Rama, dje në emisionin "Shqiptarët për shqiptarët"

zgjedhjeve, e kam deklaruar me bindje të plotë që kjo i ka të gjitha të këqijat. Rrënon familjet, prindërit shkatërrohen, ajo që kam parë pasi bëra këtë deklaratë, ishte reagimi i parë i njerëzve që nuk e donin këtë gjë. Hyjmë në një betejë për të luftuar pjesën informale. Pamë që ishte një industri e mbështetur politikisht", tregoi Rama. Ai gjithashtu rrëfeu se presioni dhe lobimi i grupeve të interesit që përfaqësojnë këtë aktivitet kishin qenë shumë i fuqishëm dhe se ai kishte bërë që shumë deputetë të ishin të

lëkundur, qoftë edhe për të shtyrë afatet e hyrjes në fuqi të ligjit. "Një nga momentet e mia të këqija si drejtues i shumicës ishte kur mbeta vetëm me Erjon Braçen për të bërë një kompromis për ta shtyrë këtë. Fuqia e lobeve nuk është e vogël, kudo në botë është e fuqishme. U vendos të shtyhet për 31 dhjetorin e këtij viti", u shpreh Rama. Ai tregoi në emision edhe momentin që u bind pse bastet dhe kazinotë duhet të mbylleshin. "Ishim në Dibër në një mbledhje qeverie. Ishte një protestë që më uronin mua mirëpritjen nga opozi-

DIBRA
"Ishim në Dibër në një mbledhje qeverie. Ishte një protestë që më uronin mua mirëpritjen nga opozita. Më thonë shoqëruesit dalim nga rruga tjetër, ishte rrugë 150 metra. Kishte rreth 20 lokale nga të dyja anët. 90% ishin baste, kazino, bingo, komplet rruga, thashë: Kjo është çmenduri duhet të ndalojë".

ta. Më thonë shoqëruesit dalim nga rruga tjetër, ishte rrugë 150 metra. Kishte rreth 20 lokale nga të dyja anët. 90% ishin baste, kazino, bingo, komplet rruga, thashë, 'kjo është çmenduri duhet të ndalojë'. Kur e sheh atë pamje, 68% e njerëzve e fillojnë 10 deri në 15 vjeç, ikin nga shkolla dhe luajnë bixhoz", tregoi Rama. Duke folur për efektet pozitive që do të sjellë familjeve shqiptarë të prekura nga bixhozi, Rama tha se paratë që i shkonin kësaj industrie, tashmë do mbeten në familje për konsum. "Këto para do futen në ekonominë e vendit. Do të krijohen biznese të tjera. Tregu do hapë biznese të tjera. Ata që janë të punësuar, do hyjnë në kurset e kualifikimit. Ne do t'i trajnojmë dhe do t'i kualifikojmë, nuk është se mungojnë vendet e punës", tha Rama.



Kryeministri: "Shqiptarët për shqiptarët" më bëri të ndihem ndryshe

Shefi i qeverisë është ndier mëse komod gjatë prezencës në studion e shqiptarëve, ku tha ndër të tjera se mund të qëndronte në emision deri në mëngjes, "ju në këtë emision jepni shembull, emisioni ka audiencë shumë të madhe duke mos bërë turr". Rama vijoi me tej duke shprehur konsideratat për emisionin "Shqiptarët për shqiptarët". Ai tha: "Më shumë më pëlqen që ju bëni bamirësi, por nuk tregoni se kush i bën. Kjo është gjëja më e bukur, bëje bamirësinë, por mos e përlit. Unë kam qenë në shumë studio, por këtë mirësi dhe njerzillëq kam e kam provuar në studio të tjera. Atje futesh njeri, por nuk e di çfarë del. Më ka pëlqyer shumë emisioni, mund të rri deri nesër".

SHKURTE

Rama: Kam luajtur një herë bixhoz, si u ndjeva kur humba

Kryeministri ka rrëfyer si asnjëherë më parë eksperiencën e tij të parë me bixhozin. Z. Rama nuk ka nguruar që të tregojë se edhe ai si shumica e shqiptarëve e ka provuar qoftë edhe një herë të vetme kumarin. Ai tha se bëhet fjalë për vitin 1992 dhe kjo do të ishte hera e parë dhe e fundit që Edi Rama ka luajtur me lojërat e fatit. "Kam luajtur njëherë bixhoz në vitin 1992, në Berlin. Isha duke ecur, atje luhej në rrugë. Ishte loja me tri kupa dhe një gogël, ishin turq ose arabë ata që luanin nga kupa duke i ngatërruar. Ti vendosje 5 marka, 5 marka për mua ishin goxha në atë kohë. Nuk fitova, humba, thashë unë nuk e bëj më këtë. Praktikisht të gjithë humbin. Kur e hapi kupën, nuk kishte asgjë. Elvisi e di shumë më mirë se sa unë. Ne shqiptarët na pëlqen ta sfidojmë fatin. Libri i Shenjtë thotë mos u merr me baste", tha shefi i qeverisë në studio.

Historia e dhimbshme e bixhozit, që i ndryshoi mendjen Ramës

Kreu i qeverisë tregoi në studion e shqiptarëve një historik të bixhozit që i kishte mbetur në mendje dhe që bëri që ai të krijojë bindjen se bixhozi duhej mbyllur në Shqipëri. "Duke e dëgjuar historinë e Vasilit, mu kujtua historia një familjeje që e kam njohur vetë. Është e pabesueshme, djali ishte përfshirë në bixhoz shumë fortë, babai përballëje me borxhet e djalit. Në një moment të caktuar u mblodhën shumë borxhe, sa familja u detyrua ta hiqte djalin nga vendi, rrezikonte nga njerëzit që kërkonin lekë. E çuan djalin jashtë, por ra babai në kurthin e këtij vesi. Nga dëshpërimi, u futën në bixhoz, humbën shtëpinë, ata janë jashtë. Nusja e djalit dhe femija janë këtu në Shqipëri. Jetojnë në kushte shumë të vështira. Humbën biznesin dhe shtëpinë, çdo gjë", tregoi Rama në studio.

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQERORE TIRANE

Kerkon nje objekt me qera per ta perdorur per zyra me kriteret e meposhteme.

1. Siperfaqja e objektit qe kerkohet 220-250 m2
2. Document pronesie mbi objektin (certifikate ose vertetim pronesie dhe planimetrine)
3. Fondi limit 9 euro per m2
4. Ndertesa te ndodhet brenda vijave kufizuese te qytetit Tirane ne nje rreze me te vogel se 0.5 km nga ndertesa e DRSSH Tirane.
5. Ambient te kete te instaluar uje dhe energji dhe te kete kushte te pershtatshme per ta perdorur si zyre ose si ambient per dokumenta arkivore, te kete hyrje me vete dhe banjo.
6. Afati i dorezimit te dokumentave do te jete dt 21.11.2018 ora 11.00.
7. Te interesuarit duhet te paraqesin planimetrine, dokument qe vertetojne pronesine dhe oferten ekonomike jo me vone se ora 11.00 te dates 21.11.2018
8. Pasi te dorezohen dokumentacioni, komisioni I ngritur per kete qellim do te beje dhe vleresimin e objektit para shpalljes se fituesit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQUERUAR ME FTESA DIREKTE

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të hua", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 45,610,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë. Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutjesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 20 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

'Lokalet', Spaho: Së shpejti do të ngrihen shtabet elektorale

Kandidatët, mbërrijnë në PD gjermanët e Merkelit dhe britanikët e May

Ekspertizë evropiane për zgjedhjen e emrave

Valentina Madani

Demokratët prej mjaft jsh kanë zbritur në terren për zgjedhjen e strukturave të reja të partisë, por edhe nisjen e procesit zgjedhor për lokalet e 2019-ës. Procesi pritet të përmbyllet brenda pak ditësh, ndërkohë që nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho, thotë për "Gazeta Shqiptare" se menjëherë sapo të mbyllet zgjedhjet në parti, do të ngrihen edhe shtabet elektorale në mbarë vendin për zgjedhjet e ardhshme lokale, por pa përfunduar as ato të përgjithshme. Mësohet se ditën e sotme dhe në vijimësi në selinë e PD-së përveç përfaqësuesve të CDU-së gjermane, do të mbërrijë edhe një përfaqësues i partisë konservatore britanike, që do të japë eksperiencën e tij për zgjedhjet lokale, por edhe ato të përgjithshme. Unioni Kristian-Demokrat gjerman, me në krye Angela Merkelin, prej kohësh i ka dhënë mbështetje PD-së për hartimin e programit të ardhshëm qeverisës dhe aktualisht po ndihmon demokratët shqiptarë edhe për zgjedhjet lokale përmes përfaqësuesve të saj, që herë pas herë vijin në selinë e PD-së për të dhënë ekspertizën e tyre. Po ashtu, po ndihmojnë edhe konservatorët britanikë të kryeministres Tereza May me ekspertizën e tyre, duke e vënë në shërbim të fitores së të djathtës në zgjedhjet e afërta lokale, por që opozita pretendon që njëherësh të zhvillohen edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme.

PROCESI

Në partinë kryesore në opozitë po zhvillohen dy procese paralele: mbledhja e propozimeve për kandidaturat për zgjedhjet lokale si dhe zgjedhja e kryetarëve të degëve dhe grup-seksioneve, një-sive bazë të organizimit të PD-së. Krahas zgjedhjes së drejtuesve në nivel vendor në të gjithë vendin, grup-seksionet kanë nisur përgatitjen e listave me kandidaturat për kryetar bashkie dhe këshilltarë. Emrat do t'i nënshtrohen një kalimi formal në kryesi dhe



Gjatë një mbledhjeje të kryesisë së PD-së

KOMISIONI

Statuti i ndryshuar i Partisë Demokratike parashikon ngritjen një komisioni të posaçëm, Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve, i cili vlerëson kandidaturat elektorale. Anëtarët e komisionit zgjidhen nga Këshilli Kombëtar me propozim të kryesisë së PD. Komisioni asiston kryesinë e PD në procesin e caktimit të kandidatëve.

Këshillin Kombëtar. Ashtu si në zgjedhjet e kaluara, ky proces, në një fazë të mëtejshme, kushtëzohet nga marrëveshja me partitë kryesore aleate për ndarjen zonave të influencës, për t'u përfaqësuar me kandidatë. LSI dhe PDIU pritet të propozojnë kandidatë për drejtimin e një pjesë të bashkive, ndërsa partitë e tjera aleate do të përfaqësohen vetëm me këshilltarë.

KRITERET

Kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilltarë të opozitës duhet të plotësojnë disa kriteret të përgjithshme dhe të veçanta. Sa u takon kriteret të përgjithshme, kandidatët duhet të kenë arsim të lartë, integritet të lartë moral, reputacion në zonën e tyre, të justifikojnë pasurinën me të ardhura të

ligjshme, të mos kenë pasur funksione gjatë regjimit komunist, të mos kenë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit si dhe të mos jenë subjekte të ligjit të dekriminalizimit. Statuti i PD parashikon një tjetër rregull për zgjedhjen e kandidatëve për këshillat bashkiakë. Sipas nenit 12 pika 3, kryesitë e degëve vendosin për kandidaturat e këshilltarëve në njësitë vendore. Kryesia e PDSH duhet të informohet për çdo hap të procesit të miratimit të kandidatëve. Ajo ka të drejtën e ndërhyrjes sa herë që e vlerëson të domosdoshme. Përfundimisht, për bashkitë qëndër qarku, lista e këshilltarëve përgatitet dhe propozohet nga kryesia e degës dhe miratohet nga kryesia e PDSH.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST for the establishment of a pool of national civil engineering and/or architect experts to conduct engineering investment works of facilities in project area

1. Brief background of the programme

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH is implementing on behalf of the German Government the project "Climate-friendly, integrated waste and recycling management (CFISWM)". During the period June 2017 to March 2018, the CFISWM project supported the three Municipalities, Himara, Peqin and Rogozhina in preparing Integrated Municipal Solid Waste Management Plans. The Integrated Municipal Solid Waste Management Plans in Himara and Rogozhina, had foreseen that the pre-treatment of solid urban waste (sorting and composting) will be performed at the Himara, Vumblo Transfer Station. The process of treatment of recyclable waste materials will be collected and processed in Rogozhina Collection Centre.

2. Purpose of the call for expression of interest and application procedure

This open call for expression of interest is intended to cover short term assistance of project support for engineering investment works of sorting and composting/stabilization facilities for municipal solid waste.

The Application deadline: is 21 November 2018.

On the basis of the information provided in the application, the Programme assesses whether the applicants meet the criteria laid down below. The applicants will be informed by the Programme not later than **30th of November 2018** whether they have been included in the pool of potential experts or not.

3. Scope of work and description of main tasks

Scope of work

Finalising Documents for Detailed Design,
Preparation of Tender Documents and Participation in Awarding Process
Carry out Site-supervision/ Implementation
Participation in the Final Acceptance
Hand Over Process including Documentation

Description of main tasks

- Preparation of the final design plans for construction
- Draft the implementation project which includes the preparation of all necessary documentation
- Preparation of an explanatory report for the planned facility
- Preparation of a cost estimate for the buildings and outdoor facilities
- Prepare tendering documents
- The Consultant shall assume all engineering functions and duties in accordance with the contractual provisions made between GIZ and the building contractor
- All Technical Services as supervisor

4. Required skills and experience

- Construction engineer and/or architect diploma
- At least 8 years of technical competence and professional experience in construction design and supervision works
- Very good analytical capacity, interpersonal and communication skills and reporting;
- **Very good command of written and spoken English and computer literate;**
- **Experienced in working in a multidisciplinary team;**

5. Documents to be provided

Experts interested in the call are invited to send their application at any time prior to 21/11/2018. Each application shall include the following documents:

- **a motivation letter** explaining why the applicant would like to be part of these pool of experts and what experience he/she has related to the scope of work
- **diploma and Curriculum Vitae** (curriculum vitae – CV, in the European format, preferably not exceeding 3 pages).
- Additional supporting documents (e.g. publications or references) may be requested at a later stage.

All documents shall be submitted in English, by electronic means at the following address hermann.plumm@giz.de or artur.galanxhi@giz.de

 Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2 TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATAKUSHTETUESE
KOLEGJII POSAÇËMI APELIMIT

RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESATË POSAÇME:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Përrafqesë së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 21 nëntor 2018, i cili duhet të vërtetohet me letë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuara. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgegjësi për njohimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Epërori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësime positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/ç, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, njoftuar nga Gjykatë Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakoshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakoshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. **Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit.

Presidenti i Republikës fton:

Cdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/email);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruës nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e lsh-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjëni të boluar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenin 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një

veprimtari të shpikuar në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës. 5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprime penale;
e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;
b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
e) kursit gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimet përfundimtarë në Shkollën e Magjistraturës;
dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Biv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: 042.389898

TIRANË - Të gjithë personat që janë marrë me organizimin dhe mbarëvajtjen e testimit për gradën komisar në Policinë e Shtetit janë nën hetim. Sipas TV "Klan", Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat referoi në prokurorin një kallëzim për shpërdorim detyre, pasi gjatë zhvillimit të testimit janë gjetur shkelje të rënda procedurale. Sipas kallëzimit, veprimet do t'i verifikohen të gjithë zinxhirit drejtues



Shkeljet në konkursin për gradën komisar, SHÇBA kallëzon në prokurori anëtarët e komisionit dhe Ardi Velin

të policisë, si anëtarë të komisionit të gradave. Mësohet se komisioni përgjegjës për organizimin e konkursit përbëhet nga vetë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu; zëvendësja e tij përgjegjëse për kufirin, Aida Hajna; drejtori i Akademisë së Sigurisë, Bil

bil Mema dhe Sokol Bizhga e Ali Allaraj. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ka gjetur shkelje në anulimin e testimit të parë të kryer më 7 nëntor. Ky konkurs u anulua me urdhër të Velikut, me justifikimin se integriteti i procesit u cenua, pasi disa

oficerë të policisë kishin kopyuar. Testimi i zhvilluar në ambientet e Akademisë së Policisë u monitorua nga afër nga drejtues të lartë të Policisë së Shtetit dhe anulimi i tij ka ngritur dyshime se shkaku nuk është ai që thuhet nga policia. Konkursentët u nënshtruan një tes-

ti me alternative, të cilat korrigoreshin nëpërmjet një pajisjeje elektronike të quajtur "skadron" dhe përgjigjja merrej brenda ditës. Sindikata e policëve e ka quajtur arbitrar vendimin e Ardi Velikut. Konkursi ishte vendosur të mbahej më 15 nëntor, por 470 efektivat që garojnë për 133 grada komisar, as nuk u futën në sallat e testimit për shkak të riformatimit të pyetjeve dhe procedurës së zhvillimit të testit.

Në moshën 15-vjeçare, Albert Alterziu vrau bashkëmoshatarin e tij

ELBASAN

Një shpërthim me granatë në një lokal ka tronditur banorët e Elbasanit, ndërsa është plagosur rëndë pronari. Ngjarja e rëndë, ku mbeti i plagosur 32-vjeçari Albert Alterziu ndodhi në orët e ara të mëngjesit të djeshëm në lagjen "Partizani" të këtij qyteti, në vendin e quajtur "Gurabardhi". Mësohet se i riu ndodhej në një dhomë ngjitur me lokalin në pronësi të tij, ku ndodhi shpërthimi. Ai është dërguar urgjentisht në spitalin kirurgjikal të Elbasanit, ku i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Bluzat e bardha të këtij qyteti bënë me dije se Alterziu ka marrë plagë të rënda, por ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë pas sinjalizimit për sulmin me granatë dore, forcat policore kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimin për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit/ve të krimin. Paraprakisht dyshohet se ngjarja të ketë ndodhur për hakmarrje, pasi më parë ka qenë i dënuar për vrasje, që e ka kryer kur ka qenë minoran.

NGJARJA

Rreth orës 03:45 të mëngjesit të djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë sulmuar me granatë dore lokalin e Albert Alterziut. Si pasojë e shpërthimit

Shpërthim me granatë në lokal, plagoset rëndë pronari 32-vjeçar

Shënjestra e atentatit, person me precedentë penalë, sulmi dyshohet të ketë si motiv hakmarrjen

VRASJA

Burime zyrtare nga Drejtoria Vendore e Policisë së Elbasanit pohuan për "Gazeta Shqiptare" se 32-vjeçari që u sulmua me granatë është person me precedentë penalë. Sipas këtyre burimeve, në vitin 2001, kur Alterziu ishte vetëm 15 vjeç ka vrarë bashkëmoshatarin e tij, Elton Shuli dhe ka marrë një dënim fillestar me 10 vite burg. Për shkak të moshës së mitur, ai ka përfutur uljen e dënimit me 7 vite burg, dënim të cilin e ka shlyer.



Lokali ku ndodhi shpërthimi

është plagosur rëndë ky i fundit, ndërsa janë shkakuar dhe dëme materiale. Burime zyrtare nga Drejtoria Vendore e Policisë së Elbasanit pohuan për "Gazeta

Shqiptare" se 32-vjeçari që u sulmua me granatë është person me precedentë penalë. Sipas këtyre burimeve, në vitin 2001, kur Alterziu ishte vetëm 15 vjeç

ka vrarë bashkëmoshatarin e tij, Elton Shuli dhe ka marrë një dënim fillestar me 10 vite burg. Për shkak të moshës së mitur, ai ka përfutur uljen e dënimit

me 7 vite burg, dënim të cilin e ka shlyer. Në vitin 2010, ai është përfshirë në një tjetër ngjarje kriminale. Ndërsa, në vitin 2011 në drejtim të lokalit të tij është qëlluar me armë zjarri. Rasti i fundit është cilësuar si atentat dhe pista ku po hetohet ngjarja është ajo e hakmarrjes. Fatmirësisht nipi i tij që ndodhej në të njëjtën dhomë ku u hodh granata që shpërtheu nuk ka pësuar dëmtime serioze. Lidhur me ngjarjen e ndodhur në lagjen "Partizani" në Elbasan, policia ka marrë në pyetje të gjithë familjarët e 32-vjeçarit si dhe disa persona të tjerë që mund të hedhin dritë për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorëve të krimin.

SHKURT

Shisnin heroinë tek "21-shi",

prangosen 2 të rinjtë
TIRANË - Policia e kryeqytetit ka goditur një tjetër rast të trafikut të lëndëve narkotike si pjesë e operacionit "CLEANER". Mësohet se gjatë këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit Ermal Demushi, 35 vjeç dhe Emirjon Doçi, 29 vjeç, të dy banues në Tiranë si dhe u sekuestruan 60 doza heroinë, armë dhe municione luftarake. Sipas bluve, dy të rinjtë në bashkëpunim me njëri-tjetrin shpërndanin heroinë me doza në zonën e "21 Dhjetorit".

Vdes foshnja në maternitet, nën hetim dy infermieret

BERAT - Një foshnjë vetëm 10-ditëshe ka ndërruar jetë në Maternitetin e Beratit. Mësohet se femlja kishte lindur nën peshë e për këtë arsye mbahej në inkubator. Ende nuk dihen shkaqet e vdekjes së foshnjës, ndërkohë që kanë filluar hetimet ndaj bluzave të bardha të këtij spitali. Materiali proceduralë i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Beratit për dy infermieret, përkatësisht për shtetaset me inicialet K.Sh. dhe T.Z., 50 dhe 52 vjeçe, banuese në këtë qytet.

Ja mesazhi i Muhamed Sytarit

Ekzekutimet në Shkodër, Myftiu: Të kthehemi te vlerat e besimit

SHKODËR - Ekzekutimi në një atentat mafioz i 40-vjeçarit Fatos Ferracaku si dhe plagosja e kunatit të tij, Fatmir Mehaj, por edhe ngjarjet e tjera kriminale të ndodhura gjatë muajve të fundit kanë shkakuar ankth e panik te banorët e Shkodrës. Duke marrë shkas nga situata e rëndë që është krijuar në këtë qytet, ka reaguar myftiu Muhamed Sytari, i cili dje ka përcjellë një mesazh të fortë. "Sot kur Shkodra është zhytur nga një mjegullnajë e zymtë, kur era e

krimit, e korrupsionit, vjedhjes, shthurjes, përhapja e fajdeve, gënjeshtreve dhe pabesisë, tendencave përherë të denigrimit të rinisë, kanë për qëllim të bëjnë ligjin e t'i ndryshojnë identitetin këtij vendi, ne e kemi për borxh moral, fetar e kombëtar të kthehemi nga vlerat e besimit. Larg besimit dhe vlerave të tij, ky vend nuk ka të ardhme", - u shpreh imam Muhamed Sytari. Fjalimi i Myftiut të Shkodrës u bë gjatë 28-vjetorit të rihapjes se xhamisë së Plumbit në Shkodër dhe në



ditën e inaugurimit të xhamisë tek ura e Bunës. Më tej imami u lut që kjo situatë të ndryshojë. Mesazhe të tilla ka dhënë edhe komuniteti i krishterë. Në 6 muajt e fundit të këtij viti në Shkodër janë vrarë 7 persona, 6 prej të cilëve në atentate mafioze, ndërkohë që ende nuk janë identifikuar autorët. Ndërsa, dy persona rezultojnë prej disa muajsh të zhdukur.

Shkak i aksidentit, lagështira në rrugë

Autobusi del nga rruga në Qafë-Thanë, plagosen 7 gjimnazistë

PRRENJAS - Një autobus me gjimnazistë nga Roskoveci u aksidentua pasditen e djeshme në Qafë-Thanë. Mësohet se automjeti ka dalë nga rruga dhe për pasojë janë plagosur 7 nxënës, të cilët ndodhen jashtë rrezikut për jetën. "Më datë 16.11.2018, rreth orës 17:00, në Qafë-Thanë, autobusi me targe AA 723 OP me drejtues shtetasin L.H., duke udhëtuar nga Korça në drejtim të Fierit, ku në këtë autobus udhëtonin nxënës të një shkolle të Roskovecit, për shkak

të kushteve të këqija atmosferike dhe nga pakujdesia e drejtuesit të mjetit ka dalë nga rruga ku për pasojë u lënduan lehtë shtetasit: L.V., 17 vjeçe; E.D. 15 vjeç; N.H. 17 vjeçe; B.Q., 18 vjeç; J.G., 17 vjeç; D.V., 17 vjeç dhe M.V., të cilët pas kontrollit mjekësor dhe marrjes së ndihmës së parë, janë në pritje të autobusit tjetër për t'u larguar për në banesat e tyre. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të shkakut të aksidentit", - thuhet në njoftimin zyrtar të



policisë. Ndërkohë, një dëshmitar në vendngjarje raportoi për "Gazeta Shqiptare" se nxënësit janë hedhur nga dritaret për të dalë, pasi autobusi kishte ngelur gjysmë në rrugë dhe gjysmë në greminë. Ndërsa, burime nga vendngjarja pohuan se autobusi me gjimnazistë rrëshqiti në kthesat e Qafë-Thanës, duke dalë nga rruga si pasojë e lagështirës.

Sonila Mulgeci: Mësuesit nën presion për vendin e punës, nuk flasin realitetin

Nisma "3 lëndë në 6 orë", më shumë sjell probleme se dobi

Nga Kejsi Lama

Nisma "3 lëndë në 6 orë" e nisur në mënyrë të befashme në semestrin e dytë të vitit shkollor që lamë pas, ende nuk ka "davaritur" kaosin e krijuar. Duket se nisma është motivuar më shumë nga rrethana që nuk lidhen me përmbajtjen e orës së mësimi; për shembull të shpëtojme fëmijët nga pesha e rëndë e çantës.

SONDAZI

Kjo duket se ka rezultuar edhe nga një sondazh që ka kryer Qendra e Trajnimit dhe Mësimshesës Shkollore "Faik Konica" me rreth 500 mësues në të gjithë Shqipërinë. Opinione të mësuesve janë shumë kritike ndaj kësaj nisme. Të gjithë mësuesit cilësonin si avantazh peshën e vogël të çantës, sepse normalisht ata mbanin vetëm 3 libra dhe jo 6 si më përpara. Ata kishin më pak ngarkesë për të mësuar në shtëpi, si dhe më shumë kohë të lirë. "Mësuesit, kanë drojen se humbasin vendin e punës nëse flasin publikisht për disavantazhët", shprehet udhëheqësja didaktike e Qendrës së Trajnimit dhe Mësimshesës Shkollore "Faik Konica", Sonila Mulgeci. Për sa u përket disavantazheve, disa prej tyre janë shprehur se orët e gjata 90-minutëshe krijojnë shpërqendrim dhe lodhje, ndërsa në orën e dytë është humbur totalisht përqendrimi. Nga ana tjetër, përqendrimi krijon për disa prej lëndëve, një lloj distance kohore për "kontaktin" e nxënësit me lëndën, dhe kjo e bën nxënësin që të harrojë mësimin paraardhës. Një tjetër shqetësim që ngrenë mësuesit është se gjatë dy orëve ka një mbingarkesë të njohurive që japin për nxënësit, duke sjellë dhe uljen e produktivitetit të tyre. "Me këtë nisim nxënësit bëhen dembel sepse nuk studiojnë aq sa duhet", shprehet mësuesi L.G. në Tiranë. "Nisma ka shkaktuar lodhje dhe mbingarkesë tek të dy palët mësues-nxënës. Infrastruktura shkollore nuk është e përshtatshme për zbatimin e saj", tregon mësuesja H.M. në Tiranë. "Në arsimin e mesëm të ulët është e vesh-

"Nxënësit lodhen, vështirësi me dy tema në një orë"



Sonila Mulgeci

tirë që fëmijët të marrin dy tema, të cilat janë të varura nga njëra-tjetra. Duhet që fillimisht të përvetësojnë temën e parë për të kaluar tek tjetra. Gjithashtu, duhet të ndryshonin dhe tekstet mësimore që t'i përshatashin orës së mësimi", tregon mësuese P.H. në gjetin e Durrësit. Sipas Klotilda Jaupit, një nga themeleset e nismës "3 lëndë në 6 orë" ajo që duhet të përmbështohet këtë vit është që mësuesit të punojnë më mirë me njohjen e programit lëndor dhe të realizojnë temat sipas ngjashmërisë me njëra-tjetrën. Në orët e mësimi duhet të planifikohen situata nga jeta e përditshme e fëmijëve lidhur me pikat kyçe të temës në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm i të nxëniet nëpërmjet të përtjetuarit, të kuptuarit dhe ndërtimit të dijes në situata të njohura e të panjohura për ta, duke kaluar nga më e thjeshta tek kompleksja dhe anasjelltas.

NXËNËSIT

Reagime pro dhe kundër nismës ka pasur edhe nga nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnaz. Në disa intervista të shkurtra, të bëra me nxënës të gjimnazit "Ismail Qemali" dhe shkollës 9-vjeçare "1 Maji", ata përgjigjen si më poshtë: S. P. nxënese në gjimnaz. "Avantazhet janë ato që

janë folur gjithë këto kohë, na lehtësoi peshën e rëndë të çantës. Po, për mendimin tim, vetëm kaq ka qenë e favorshme. Sepse të bësh një lëndë dy orë të humbintere-



Klotilda Jaupi

si dhe mësuesit nuk e zbatuan kushtin që orën e parë mësim dhe orën e dytë të bëhen detyra ose të na pyesnin. Të paktën në gjimnaz jo. Dhe është diçka këtu. Nëse ata menduan se po na lehtësoi në këto tre orë, e kanë gabim, sepse duke bërë dy orë mësim, dihet që do jepet dy mësim dhe teoritë është më e lehtë për na bie të mësojmë përsëri gjatë herë po për 3 lëndë vetëm. Kështu që as këtu s'ka ndonjë të mirë. Dhe si mbyllje nëse një mësues mundon goftë edhe një ditë, i thonë të humbasim dy orë mësim dhe këto t'i bashkëngjiten mësimi pasardhës, ku praktikisht në dy orë të merren katër tema. Nuk kënaqemi më nëse

NGARKESA

Të gjithë mësuesit cilësonin si avantazh peshën e vogël të çantës, sepse normalisht ata mbanin vetëm 3 libra dhe jo 6 si më përpara. Ata kishin më pak ngarkesë për të mësuar në shtëpi, si dhe më shumë kohë të lirë. "Mësuesit, kanë drojen se humbasin vendin e punës nëse flasin publikisht për disavantazhët", shprehet udhëheqësja didaktike e Qendrës së Trajnimit dhe Mësimshesës Shkollore "Faik Konica", Sonila Mulgeci.

atikë është qejf, por në histori nuk është shumë mirë, sepse mezi i mësoj dy mësimë".

REAGIMI I SPASH

Për të parë nëse kjo nisim e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ishte e suksesshme, kryetarja e Sindikatës së Pavarur të Arsimit për Tiranën, Alma Lama, foli për rezultatin e nisim dhe ndryshimet që u bënë për këtë vit të ri shkollor.

Nga kontaktet e përditshme që kemi me mësuesit ku qëndron problemi lidhur me nisimën "3 lëndë në 6 orë"?

Unë jam një mësuese që zhvilloj lëndën e kimisë 9. Problemi i nisim qëndron në faktin që kjo nisim duhet të testohet në fillim, pasi u përballëm me shumë probleme gjatë implementimit. Tekstet nuk janë të përshtatura për të zhvilluar dy tema të njëpasnjëshme. Kur shpjegojmë dy tema të reja, është shumë e vështirë, pasi e forcojnë nxënësin dhe mbingarkojnë, nuk marrim përqendrimin e mjaftueshëm të fëmijëve. Ndërsa, në orën e dytë gati na dështon procesi i të nxëniet.

Në këndvështrimin tuaj, cilat janë 3 nga arritjet e kësaj nisme?

Do të rendisja vetëm dy, kur bëj tema të integruara me lëndë e tjera më ndihmon. E dyta, si mësuese gjej më shumë kohë të plotësoj dokumentacionin, por kjo nuk është më dobi të nxëniet.

Ky vit shkollor, çfarë ndryshimesh do të sjellë lidhur me këtë nisim?

Ne si mësuesit na angazhuam në hartimin e planeve vjetore, duke grupuar temat që janë komplementare gjatë një 90-minutëshi. Kjo është përshtatja e vetme që kemi në dorë. Ne mësuesit jemi zbatues në institucione shkollore, zbatues të urdhrave dhe udhëzimeve të MASR. Nuk ka ndryshime, udhëzimet na janë dhënë, po vazhdojmë të zbatojmë.

mundon mësuesja, sepse na pret një ngarkesë shumë e madhe. Pra, mua nuk më pëlqen ky ndryshim fare, nuk shoh shumë avantazhe".

E. L. NXËNËSI 2 GJIMNAZ

"Mendoj se avantazh është se ke më pak libra dhe më shumë kohë për të mësuar. S'kemi shumë ngarkesë. Disavantazh se bëhen shumë të lodhshme 2 orë dhe monotone".

XH. F. NXËNËSE 3 GJIMNAZ

"Avantazh është se s'kishim shumë ngarkesë në çanta. Nxënësi apo zysha kishin më shumë mundësi për t'u shprehur dhe për të shpjeguar më me detaje mendoj. Kur kishim provim, kishim 1 orë kohë të përsërisim para tit dhe pastaj bënim provim. Gjithashtu, disa ditë ishin qejf se kishim 3 orë të lehta dhe nuk mësonim shumë. Disavantazhi është se ka shumë lëndë që është e teprët të bënim dy orë, kur mund t'i zëvendësonim me të tjera më të rëndësishme".

NXËNËS I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

"Ajo që më ka pëlqyer është se u lehtësova me detyrat e shtëpisë dhe mësoja më pak. Më humbet interes gjatë orës së mësimi se zgjat shumë. Nuk më pëlqen se marrim dy mësimë në një ditë. Në matem-

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka venë hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:

- Lloji i pasurisë Are+ Truall** me sip. 3000 m², nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475, Derven, KRUIË
- Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) EUR. Ankandë zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimorës gjyqësore, me adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilën ka venë hipotekë NBG Bank, me këto të dhëna:

- Lloji i pasurisë sip**, 189 m², nr.pasurie 5/188nd-1, zk.8350 vol 28 fq146 RR.P.MYZOQARI TIRANË në pronësi të z.Ajzen Rahmi BAHOLLU
- Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 256.800 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) EUR
- Lloji apartamenti sip.132m² zk.8350 nr.pas.5/188nd-1-1/9 vol 28 fq 185 Rruga Prtopk Myzoqari TIRANË në pronësi të z.Ajzen Rahmi BAHOLLU
- Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 105.600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëdhjetë) EUR
- Ankandë zhvillohet në datën 03.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimorës gjyqësore, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BALIFF SERVICE E HOXHA" sh.p.k njihon Shpalljen e Ankandit të l-rë, për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615

Numeri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z. Bajram Selfer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandë i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 2.720.000 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë) LEKE.

Ankandë do të zhvillohet më datë 21.11.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BALIFF SERVICE E HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telofon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" AKTIVITETI

Ruka: Po hedhim hapat e para për bashkëpunim. Montroni: Institucion prestigjioz

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" pret mitin e librarëve italianë, Romano Montroni

Leksion i hapur mbi teknikat e menaxhimit të librit

Në kuadër të panairit të librit, universiteti "Luarasi" ka pritur këtë të premte menaxherin mitik të librarive "Feltrinelli", personalitetin e shquar italian, Romano Montroni. Studentët e Fakultetit Ekonomik patën mundësinë e artë për të ndjekur leksionin e hapur mbi teknikat bashkëkohore të menaxhimit dhe marketimit të librit. Gjatë bashkëbisedimit me studentët, Montroni prezantoi veprën e tij "Të shesësh shpirtin- zanati i librashitësit" për të përcuruar përvojën e tij më të mirë tek të rinjtë e "Luarasit". Miti i librarëve italianë u përpoq të tregonte edhe njëherë vlerën e jashtëzakonshme të librit në formimin arsimor, kulturor e vetë jetën e një kombi. Në aktivitet, ishte e pranishme edhe drejtoresha e Institutit Italian të Kulturë, Alessandra Malgarini. Rektori i "Luarasit", prof.dr. Ethem Ruka u shpreh tejet i nderuar për vizitën e këtyre personaliteteve të shquara dhe theksoi se janë hedhur hapat e parë për bashkëpunim të frytshëm në të ardhmen. "Jam shumë i nderuar që jeni këtu. Ne ramë dakort që kur të kemi një vizitë të rektorëve të universiteteve italiane, të organizojmë një ditë, një takim këtu në universitetin "Luarasi" për të parë pikat e takimit dhe bashkëpunimit me to, për të shtuar gamën e bashkëpunimeve dhe veçanërisht për të arritur atë që ne kemi dëshirë, shkëmbim përvojash në nivel universitar", theksoi Ruka.



Rektori i "Luarasit", prof.dr. Ethem Ruka, dje gjatë leksionit të hapur



Menaxheri mitik i librarive "Feltrinelli", Romano Montroni, dje në universitetin "Luarasi"

një nga universitetet më të mira në Shqipëri, të mund të shkëmbejë studentët e tij me universitete të tjera në Itali", tha Toçi. Më tej, zv. rektorja e universitetit Luarasi, Luljeta Minxhozi tregon se ky leksion i hapur do të shërbejë si një eksperiencë e vyer për studentët. "Leksioni i hapur i mbajtur në universitetin "Luarasi" nga miti i librarëve italianë, Romano Montroni është një eksperiencë e veçantë për studentët tanë. Ky libër i prezantuar nga ky personalitet i shquar është shumë i dobishëm për studentët e menaxhimit, sepse iu ofron një qasje tjetër. Kjo ishte një qasje provokative që iu tregonte studentëve se në këtë botë që jetojmë ne çdo gjë mund të jetë e përdorshme në mënyrë eficiente, në mënyrë që atë që ke ti ta përdorin edhe të tjerët", u shpreh zv. rektorja e universitetit "Luarasi", Luljeta Minxhozi. Nëpërmjet leksioneve të hapura me personalitete të shquara, "Luarasi" dëshmon edhe njëherë se vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në treg, duke sjellë të studentët përvojat më të mira ndërkomëtare.

VLERA E LIBRIT

Vetë miti i librarëve italianë, Romano Montroni tregon se cilësia e studentëve dhe stafit akademik të "Luarasit" janë një vlerë e madhe për këtë universitet prestigjioz. "Qëllimi i këtij leksioni ishte që të bëja të kuptonin studentët vlerën e librit dhe cilat operacione apo veprime marketimi mund të ndërmerren. Gjithashtu, në këtë aktivitet,

u përpoqa t'u shpjegoj studentëve se libri në vetvete ka një vlerë të madhe. Më bëri shumë përshtypje cilësia e studentëve të universitetit "Luarasi", e kjo është një vlerë për institucionin. Përshtypjet më pozitive vijnë edhe për stafin akademik e mendoj se profesorët janë në lartësinë e duhur në këtë ambient kaq prestigjioz si universiteti "Luarasi". Mund të them se

kemi ndërmarrë disa hapa, kemi hedhur disa baza që i kemi diskutuar me stafin për të lidhur bashkëpunime me universitetin "Luarasi", tha Romano Montroni në fjalën e tij. Ndërkohë drejtoresha e shtëpisë botuese "Toena", Irena Toçi thotë se ky aktivitet është baza e fillimit të bashkëpunimeve të mëtejshme mes Luarasit e universiteteve italiane. "Qëllimi ynë

si botues të Romano Montroni-t në shqip, arriti maksimumin me këtë takim në universitetin "Luarasi". Në takime të tilla dalin gjithmonë bashkëpunime për të ardhmen. Unë besoj që u hodhën themelet për një bashkëpunim të ardhshëm mes universiteteve italiane dhe atij "Luarasi", me synim që ky universitet privat i rëndësishëm, i akredituar si



Dje gjatë leksionit të hapur në universitetin "Luarasi"



NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 8 / 58 + 1 - 4 , e Illojt 'Apartment', volumi 3 , faqe 188, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 75 m², në bashkëpronësi të ENGJELL LUAN TOPORE dhe NATASHA LUMAN TOPORE , me adresë: Rruga "Th. Ziko", Pallati 65 / 3, Tiranë.

ÇMIMI 36.350 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 101 / 8, "Trull + Ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale 3096, volum 8, faqe 115, me sipërfaqje 3.200 m², nga të cilat ndërtesa ka sipërfaqje 166 m², në bashkëpronësi të YAHIA Muhamed Zakaria FARWATI dhe BRXHILDA Batfjar FARWATI, me adresë: Qerekë, KRUIJE.

ÇMIMI 114.508 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria e paluajtshme kolaterale të Illojt "Pyl + Kullotë", me sipërfaqje totale 190.000 m², zona kadastrale 3028, me adresë POROVLORË, në pronësi të hipotekuesit z. FATION UKA.

ÇMIMI 1.149.120 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit , pjesa e VII

5.700 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkoi përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Të gjithë personat kanë afati deri më



9 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahësim me dëshminë e

trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medomos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq.

EMRAT ME PERFITUESIT E KOMPENSIMIT TE TE PERNDJEKURVE

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	ATESA	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIF. KATE VORBE	CERTIF. KATE FERINGUT FAMILIAR	DESIMI TRASHGIM	PRO-KURBE	CERTIFIKAT E GJENJERA LITESH
	BESHK	FATIME	HAMIT	KRIU	X	X				X	X	X
	PERLAT	HAMIT	KRIU	X	X	X				X	X	X
	LIRI	HAMIT	KRIU	X	X	X				X	X	X
1133	MEHMETI	METHASANI	KRIU	X	X	X		V		X	X	X
	SABRI	MEHMETI	METHASANI	V	X	V		V	V	V	V	V
				V						P1		
				V						P1		
	MUNIR	MEHMETI	METHASANI	V				V	V	V	V	V
				V						P2		
				V						P2		
				V						P2		
				V						P2		
	XHAHAT	MEHMETI	METHASANI	V	X	V		V	V	V	V	V
				V						P2		
	DESTAN	MEHMETI	METHASANI	V	X	V		V	V	V	V	V
				V						P4		
				V						P4		
	SERVETE	MEHMETI	METHASANI	V	X	V		V	V	V	V	V
	BUKURBI	MEHMETI	METHASANI	V						P4		
	SHERPIA	MEHMETI	METHASANI	V						P4		
1193	DOBE	WORFI	MEHMETI	X	X	X		X	X	X	X	X
2289	NIKOLLA	MILITI	MAKRI	X	X	X		V	V	V	V	V
	DIANE	NIKOLLO	RECI	X	X	X				P		P
	DEJTA	NIKOLLO	RECI	X	X	X				P		P
	FATMER	NIKOLLO	MILITI	V	V	V		V	V	V	V	V
	MAHDI	NIKOLLO	MAKRI	X	X	X				P		P
	MEHDI	NIKOLLO	PRENKA	X	X	X				P		P
3968	PAL	DEJGONAJ	NDUE	DEJGONAJ	X	X		V	V	V	V	V
	KATRINE	ASHTON	DEJGONAJ	X	X	X		V	V	V	V	V
	LEGA	KRISTINA	DEJGONAJ	X	X	X				P		P
9494	LEONARD	MIHALI	MIHALI	V	V	V		V	V	V	V	V
	ERMELINDA	LEONARD	LLIURA	V	V	V		V	V	V	V	V
5160	REIS	SELFO	MERDIME	REIS	TALPI	V		V	X	V	V	V
	SEJT	REIS	SELFO	V	V	V		V	V	V	V	V
	ARSHI	MARGARITARI	REIS	V	V	V		V	V	V	V	V
8574	ARSHI	MARGARITARI	REIS	V	V	V		V	V	V	V	V
	J. BIRJANA	PERHIL	MARGARITARI	V	X	X						
	REIS	MARGARITARI	PERHIL	V	X	X		V	V	V	V	V
	FATMIRIE	REIS	PERHIL	V	X	X						
				V	X	X						
				V	X	X						
				V	X	X						
3571	HANANI	SELAJ	ISTEF	HANANI	SELAJ	V		V	V	V	V	V
	SHERIE	HANANI	ISTEF	HANANI	SELAJ	V		V	V	V	V	V
8604	NIKOLLO	BIHACI	DEJON	NIKOLLO	BIHACI	V		V	V	V	V	V
	EDJON	NIKOLLO	BIHACI	V	X	X		V	V	V	V	V
	LEK	NIKOLLO	BIHACI	V	X	X		V	V	V	V	V
	MARHETA	NIKOLLO	LIESH	V				V	V	V	V	V
4829	BEQIR	HOXHA	PASHI	GJOKA	BIHACI	V		V	V	V	V	V
3931	KOCCO	TASHI	LEK	KOCCO	TASHI	V		V	X	V	V	V
	NAPOLFON	TASHI	LEK	KOCCO	TASHI	V		V	X	V	V	V
				V	X	X		V	V	V	V	V
				V	X	X		V	V	V	V	V
4351	SALJ	CARO	LEJZA	NAZIF	CARO	V		V	V	V	V	V
	ENRIH	SALJ	CARO	V	V	V		V	V	V	V	V
2776	NESHAT	KULLA	DANZIRKE	NESHAT	KULLA	V		V	V	V	V	V
				V	V	V		V	V	V	V	V
				V	V	V		V	V	V	V	V
672	LEC'	GHELAI	MAC	TINE	LEC'	GHELAI	V		V	V	V	V
	SKENBER	MUÇAJ	TINE	LEC'	GHELAI	V		V	V	V	V	V
1929	FADH	ZENEFI	NANDE	SKENBER	PEZILLAJ	V		V	V	V	V	V
7992	LEK	KOLAJ	FADH	ZENEFI	V	V		V	V	V	V	V
	ANSHIRAN	LEK	KOLAJ	X	X	X				P		P
	NANI	LEK	KOLAJ	X	X	X				P		P
	TONE	NDOÇ	KOLAJ	X	X	X				P		P
	NIKOLLO	LEK	KOLAJ	X	X	X				P		P
3805	GJIN	PEÇAKU	GJELA	NDUE	PEÇAKU	V		V	V	V	V	V
	MIBELI	GJIN	PEÇAKU	V	X	X		V	V	V	V	V
5335	SHABAN	PLAKA	BIM	SHABAN	PLAKA	V		V	V	V	V	V
4100	MARRK	DOÇI	GJELA	GJIN	DOÇI	V		V	V	V	V	V
	MARTE	MARRK	DOÇI	GJELA	GJIN	V		V	V	V	V	V
	GJILJANA	MARRK	DOÇI	GJELA	GJIN	V		V	V	V	V	V
	SILVA	MARRK	DOÇI	GJELA	GJIN	V		V	V	V	V	V
	NIKOLLO	MARRK	DOÇI	GJELA	GJIN	V		V	V	V	V	V

4374	DEMIR	VILLA	MOJE	DEMIR	SULSTARONA	V				X	X	V
			PIERO	DEMIR	VILLA	V				X	X	V
2413	FADH	XHINDI	GABRIELINA	SADIK	XHINDI	V		X	X	V	V	V
			NERMIN	FADH	MURAJ	V		X	X	V	V	V
			DHURATA	FADH	YSKA	V		X	X	V	V	V
			ENJAKET	FADH	XHINDI	V		X	X	V	V	V
			ARIJAN	FADH	XHINDI	V		X	X	V	V	V
			KRENAR	FADH	XHINDI	V		X	X	V	V	V
137	XHEMAL	LANI	ILIJAN	XHEMAL	LANI	V		V	V	V	V	V
			PAVLIN	XHEMAL	LANI	V		V	V	V	V	V
408	NAZI	HOXHA	DIANA	NAZI	DALLA	V		X	X	V	V	X
			ELENAJETA	NAZI	ROKHA	X		X	X	V	V	X
			SHERIF	NAZI	ROKHA	X		X	X	V	V	X
5388	PAL	ÇOKU	DAVITA	PAL	KACORRI	V		X	X	V	V	V
			LEZA	PAL	TORALI	V		V	V	V	V	V
			NDUE	PAL	ÇOKU	X		X	X	V	V	V
6601	MIBELI	DEDA	PAVLIN	MIBELI	DEDA	V		V	V	V	V	V
			TEREZA	PRENGA	DEDA	V		V	V	V	V	V
18	SULIM	KOÇI	MENDUKE	NHAFER	KOÇI	V		V	V	V	V	V
			DHURATA	SULIM	KOÇI	V		X	X	V	V	V
			MARIJA	SULIM	MERIA	V		X	X	V	V	V
			MIRAZA	SULIM	KOÇI	V		X	X	V	V	V
			MYZEJEN	SULIM	KOÇI	V		X	X	V	V	V
			KADRONIA	SULIM	KOÇI	V		X	X	V	V	V
			SANDIE	SULIM	TABAKU	V		X	X	V	V	V
			SUKULLAM	SULIM	KOÇI	V		X	X	V	V	V
			VJERLE	SULIM	MICA	V		X	X	V	V	V
3587	PRENG	GJONMARRAJ	TEJUP	PRENGA	GJONMARRAJ	V		V	V	V	V	V
			GASPER	PRENGA	GJONMARRAJ	V		V	V	V	V	V
3885	EMIN	MECO	BESHIR	EMIN	MECO	V		X	X	V	V	V
61	KALISH	KOLAJ	SHYQYRANE	REKHEP	KOLA	X		X	X	V	V	V
1580	RAMADAN	DJALANI	SHYQYRANE	REKHEP	KOLA	X		X	X	V	V	V
3826	GEG	LLESHI	DJALANI	LLESHI	KOLA	X		X	X	V	V	V
5362	LLESHI	TOMA	DJALANI	LLESHI	KOLA	X		X	X	V	V	V
			DJALANI	LLESHI	KOLA	X		X	X	V	V	V
5336	IBRAHIM	PLAKA	HEMJE	FEJZI	PLAKA	V		X	X	V	V	V
9697	COL	SVLAJ	SABRI	COL	SVLAJ	V		X	X	V	V	V
10872	LIJAZARAO	RUCCO	DHIMITRA	LIJAZARAO	SHARDHO	X		X	X	V	V	V
			FILLORETA	JORGO	SHARDHO	X		X	X	V	V	V
			KOZETA	LIJAZARAO	SHARDHO	X		X	X	V	V	V
			MARIANA	LIJAZ	SORE	V		X	X	V	V	V
			NESTOR	LIJAZARAO	SHARDHO	X		X	X	V	V	V
7362	FARODIN	TOMORI	ANASTASIA	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
			DHIMITER	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
			PAUKA	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
			MURKADZ	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
			SOJHE	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
			MARCO	FARODIN	TOMORI	X		X	X	V	V	V
7227	GEORGE	PAPAS	SHERIF	HAMZA	PAPAS	X		X	X	V	V	V
			DOROTHEA	GEORGE	PAPAS	X		X	X	V	V	V
			LEGOR	GEORGE	PAPAS	X		X	X	V	V	V
			PAVLLO	GEORGE	PAPAS	X		X	X	V	V	V
			DONIKA	GEORGE	PAPAS	X		X	X	V	V	V
			VALENTINA	HAMZA	ALIBEAI	X		X	X	V	V	V
14088	HAMZA	SHEHU	ALEXSANDRA	NAPOLEN	TASHI	V		X	X	V	V	V
			ALI	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			ABREN	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			ARISANAND	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			BALKEZE	FASLI	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			FERIDANAND	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			NEJMEDIN	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
			ROBERT	HAMZA	SHEHU	V		X	X	V	V	V
			SHERIF	HAMZA	SHEHU	X		X	X	V	V	V
12978	LEKA	TOTO	VALENTINA	HAMZA	ALIBEAI	X		X	X	V	V	V
			MIDREFT	SUJAT	TOTO	V		V	V	V	V	V
			EMA	LEKA	TOTO	V		V	V	V	V	V
			ISMET	LEKA	TOTO	V		V	V	V	V	V
9832	NIKOLLO	NIKOLLO	BEQARI	BEQARI	BEQARI	X		X	X	V	V	V
11389	ALFONS	BEGARI	KRISTIAN	BEQARI	BEQARI	X		X	X	V	V	V
			BEQARI	ALFONS	BEQARI	X		X	X	V		

Table with columns for ID, Name, and various categories. Rows include names like BESNIK SHUKRI, DALI SHUKRI, and others.

Table with columns for ID, Name, and various categories. Rows include names like FATIME SHEVDEI, GJYLIE SHEVDEI, and others.

(vijon nesër)

PROMOVIMI

Ismail Kadare:

Sunduesit shpirtërorë dhe ata tiranë

Fatmira Nikolli

Radhët e gjata, e lexuesit që shtyhen para standës së Onufrit për të marrë një autograf, e fshëhin Ismail dhe Helena Kadarenë. Të ulur në tryezën e shpësisë botuese, për të pritur publikun, ata duket se janë kthyer në shtëpinë e vet - mes librave e lexuesve. Për krahas të, besnik si gjithnjë, botuesi Bujar Hudhri, është eminenca gri. I ka munguar panairit Kadare këto vitet e fundit e këtë mesnëntor e sjell aty, botimi më i ri. "Kur sunduesit grinden", merr shkak nga një bisedë telefonike, mes Stalin dhe Pasternakut, kur pusheteti i kohës kishte shtënë në burg mikun e tij poet. Ato që u thanë në atë telefonatë të papritur edhe sot pas pothuaj një shekulli, interpretohen në mënyra kundërtshënës. A e mbrojti kolegjin Pasternaku? Apo e la' në baltë? Ç'domethënie pat një fjalë, a një pauzë mes frazave? Si u interpretuan ato që tha me gjysmë zëri para timbrit arrogant e shantazhues së diktatorit? Dhe në fund, fuqia e cilit kushton më shumë, shkrimtarit si sundues i shpirtit, apo diktatorit si sundues tiran?

"Sunduesit janë dy palët e librit, ata që janë sundues, që quhen tiranë, diktatorë, por, nga ana tjetër, unë sjell këtu edhe sunduesit shpirtërorë. Këtu ka një telefonatë, është një grindje, në fakt, midis Stalin dhe Pasternak, por aq e ngatërruar është sa që ka një shekull që nuk zëbërthehet tamam lidhur me marrëdhëniet e ndërlikuara të shkrimtarit dhe sunduesit. Ky është një realitet, duhet ta pranojmë të gjithë, ky ndodh, ka ndodhur tërë jetën e do të ndodhë gjithmonë", tha Ismail Kadare para mediave djë. Ai vuri në dukje se materialet arkivore të mbledhura ndër vitet për këtë ngjarje, për të cilën versionet janë të ndryshme, e kanë bindur edhe më tepër Kadarenë, që në Shqipëri duhet hapur dosjet. "Nuk është i pamundur, është plotësisht i mundur, por ka një pengesë që duhet që të na shqetësojë të gjithëve. Pengesa jemi ne, duke nisur nga ju, nga ne, nga të tjerët", tha ai.

Shkrimtarja Helena Kadare dhe bashkëshortja e Ismailit u ndal më gjatë tek raporti që i shoqi ka pasur me këtë veper. "Ky libër, i ka ngrënë më shumë kohë. Dokumentacioni sa vinte e shtoej, ndonëse telefonata mes Pasternakut e Stalinut ka

Shkrimtari në panair për librin "Kur sunduesit grinden", raporti i njeriut të letrave me diktatorin

Helena Kadare: Vepra ime nuk do kishte vlerën e veprës së tij, ndaj dikur bëra një zgjedhje

zgjatur vetëm tre minuta. Ai tre minutësh, përbën një nga enigmat më të mëdha të historisë së letërsisë. Në këto tre minuta ka ndodhur një bisedë, ku Stalin i pyet Pasternakun se çfarë mendon për Osip Mandelshtamin (poet i arrestuar). I hutuar në apartamentin e tij, Pasternak, në momentin e parë dha një përgjigje të çuditshme, tha Helena, duke shtuar se shkrimtari i tha Stalin: "Nuk di të them, se ne shkruajmë në mënyra të ndryshme". Ndërsa, Stalin i përgjigjet: "Nuk dite ta mbrosh mikun tënd". "Ai deshi përsëri që t'i rikthehej, por Stalin e mbylli telefonin. Numri me të cilin e kishin telefonuar ishte njëpërdorimësh. Pasternaku nuk mundi ta thërriste më. Ndaj kjo ishte brenga e madhe e vazhdueshme për të. Për këtë bisedë janë dhënë

shumë variante, shënimet e këtyre e kanë mbushur shtëpinë tonë ndër vite, sepse Ismailin gjithnjë e ka tërhequr kjo. I ka dhënë variantet e tij bazuar në dëshmitë e shumë njerëzve, që kanë asistuar apo dëgjuar më pas se çfarë ka ndodhur". Për Helenën, lexuesit e rinj që e prisnin Kadarenë për autograf janë mbase imazhi më i mrekullueshëm i panairit. "Për një grua që e do letërsinë, edhe që do edhe ajo të bëjë letërsi nuk është e lehtë që të jetë në jetë bashkë me një shkrimtar. Atëherë duhet bërë zgjedhja. Unë që në fillim i dhashtë një zgjedhje në vetën time, që më erëndësishme është puna që bën ai, që në fillim vendosa që të mbështes, duke lënë pas dore krijimtarinë time. Mund të kisha bërë më shumë në sasi, por jo në atë vlerë që ka libri i tij. Kështu



që e lashë mënjanë egon e një krijuesi. Megjithatë, aq pak sa kam bërë kam pasur përherë mbështetjen e tij", tha Helena edhe një herë.

Sa i takon librit të fundit, Helena tha se "e gjithë pjesa që është shkruar; është krejtësisht e përfunduar. Mbetet fundi. Nuk është i kënaqur me fundin. Në fakt, nuk donte që ta çonte në shtyp. Edhe fundi bëhet fjalë për disa faqe, që mund ta ribëjë më vonë, siç ka bërë 'Mbamarrëveshjen'. Nuk duhet ta mosmetem në duar. I gjithë libri është i përfunduar", tha bashkëshortja e shkrimtarit. Ndonëse i gjithë libri është i përfunduar, Ismail Kadare, ka dëshirën që në vazhdim të rishikojë edhe njëherë mbylljen e këtij libri.

BOTUESI

Botuesi Bujar Hudhri, në gazetën që ka nxjerrë, "Exlibris" e përjavshme kulturore kushtuar letërsisë, kujton një vizitë në Moskë me Ismail Kadarenë më 2010 kur për shkrimtarin xhironjë një libër. I vetmi çast, kur Kadare u gjallërua nga bota e mendimeve ku kishte rënë, ishte gjatë vizitës në Peredelkino të vila e Pasternakut. Duke rrefyer çaste të ndryshme të asaj vizite, ai kujton se në dhomën e hotelit të shkrimtarit televizori nuk punonte. Kur shkuan të shihnin çfarë kishte, sapo ekrani u ndez, në të shfaq imazhi i Pasternak-transmetohej një dokumentar për të.

"Kur Kadare më dorëzoi faqet e para të librit të ri, tre vjet më parë,

m'u duk sikur isha ende atje, në atë dhomë të atij hoteli të stërmadh, me një emër të denjë për të, 'Kozmos'. Dhe gjeja e parë që më shkolli ndër mend ishte se po e gjeja zanafilën e këtij libri. Kisha qenë me autorin pikërisht në ato vende që lexova në dorëshkrim dhe kjo më dukej kaq e natyrshme ta mendoja kështu. Por çdo ditë që kalonte, aq më shumë më largohej ky mendim", shkruan Hudhri. Shton se ky libër mbase e ka zanafilën tek romani "Muzgu", kur ishte një gjimnazist dhe debatonte me shokët se kush ishte më i madh, Kadareja apo Agolli? Apo te poemat për Lorën, po si nuk ke një vjershe për Moskën? Edhe më herët akoma, ndoshta, që në lindjen e shkrimtarit, sepse Pasternaku këtu është sivëllai i tij, Kadare. Menjëfat më të bukuri, natyrisht. Për fatin e ne të gjithëve. Për të gjitha gjuhët e botës", shënon Hudhri.

SHKURTE

KONCERT I KUINETIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE NË QYTETIN E KORÇËS

Nga Eno Koço

U ndodha në Korçë në vjeshtën e 2018-ës dhe mbrëmja e një dite e solli të ndiqja një koncert tepër tërheqës të kuintetit me piano të Universitetit të Arteve të Tiranës. Teatri i dramës në Korçë kishte një sallë me një akustikë mjaft të mirë edhe për muzikë dhome, sallë që kishte marrë vlerë të reja e shkëlqim pas restaurimit. Organizatorët e këtyre koncerteve, në mënyrë të veçantë Zamira Kita dhe Pandi Bello, i kanë dhënë një emër të mirë qytetit duke ftuar herë pas here grupe muzikore të nivelit të admirueshëm. I tillë edhe koncerti këtij kuinteti. Në qendër të programit solistët e kuintetit kishin "Troftën" e Shubertit, veper aq e njohur dhe me aq pretendime artistike. Të pestë muzikantët shpalosnin cilësitë e tyre individuale, por dhe të fuzionit të kompaktësisë së ansambllit. Koncertmaestri i kuintetit, violinisti Lorenc Radovani, i kishte dhënë veprës së Shubertit tonin dhe shijen me të cilat ajo njihet, përçimin e lumturisë përmes një shtatërvani melodish aq joshëse. Tingulli e vibratoja e Lorencit ndihmonin më së shumti në ngjyrimin kumbues të ansambllit. Roli i pianos në këtë kuintet është parë-

sor dhe Vojsava Manaj me një teknikë lakmuese pianistike, pastërti e sonoritet, ndërtonte ritmet vallëzuese me surpriza muzikore nga më tërheqëset. Këta dy solistë kishin privilegjin të kishin partnerë të tingullit dhe shijes violinistin potent e robust, balancëmbajtësin e ansambllit-Arian Paço, violonçelistin elegant, me tingull të ngrohtë e lojë të çlirët-Gëzim Belegu, ashtu dhe kontrabasistin e kultivuar, themelbajtësin dhe reverberuesin e kuintetit-Arben Basha. Janë këta interpretë që në të njëjtën "Soirë" muzikore përcollën pas Shubertit edhe katër vepra të tjera: Zadeja-Humoreska, Gaci-Perpetum mobile, Dvořák-Valle Sllave Nr. 8, Brahms Valle Hungareze Nr. 6. Natyrisht këto vepra nuk kishin peshën e Shubertit, aq më tepër që ishin transkriptime për formacionin e këtij kuinteti, por përfsahirja e veprave më në zë shqiptare për këtë formacion është për t'u përsëritur. Meriton inkurajim të vërtetë e të sinqertë, puna e Lorenc Radovani për këto përshtatje/transkriptime, edhe pse kjo është një përgjegjësi që nuk merr fund me një ekzekutim të vetëm. Atmosfera e ngrohtë që të krijon Korça për koncerte të kësaj natyre dhe të këtij niveli, e pasuruar nga publiku i saj artdashës, të shpie në reflektime të njëjdit viteve më parë kur në Korçën e Thoma Nasit hidheshin themelet e një muzike të mirëfilltë kult. Stina koncertore e Korçës është rezultati mahnitës.





BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 623

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

E shtunë 17 nëntor 2018

**SHTATZENË DHE PLOT NUR,
JA NGA CILAT ZAKONE HEQ
DORE ANJEZA SHAHINI**



**PAS NNDARJES ME SELDIN,
MIMOZA "NË KRAH" TË
REPERIT TË NJOHUR?**



GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela ALIAJ

ZHVISHET MISI SHQIPTAR

DASHURIA BILAJ:

*Ja pse e mora
këtë vendim*

Misi shqiptar pozon nudo në bregdetin e Vlorës

"Kjo është pjesë e të qenit artiste, prindërit më kanë mirëkuptuar"



VIVIAN CANAJ

**Vjen në jetë Christian,
modelja shqiptare bëhet
nënë për herë të parë**

Prek me fjalët dedikuar djalit: Paç shkëlqimin e diellit çdo ditë të jetës shpirt i shpirtit tim!




Vjen në jetë Christian, modelja shqiptare bëhet nënë për herë të parë

Prek me fjalët dedikuar djalit, Vivian Canaj: Paç shkëlqimin e diellit çdo ditë të jetës shpirt i shpirtit tim!

Pamela Aliaj

Edhe pse prej muajsh kaloi në heshtje një shtatzëni të ëmbël, ditën e enjte ajo solli në jetë fëmijën e saj të parë. Modelja e njohur shqiptare, Vivian Cani është bërë nënë për herë të parë, duke sjellë në jetë ëngjëllin e saj të quajtur Christian. Ka qenë vetë Vivian ajo që ka publikuar një foto me dorën e të voglit të porsalindur. "15.11.2018 u bekuam me ndjesinë dhe dhuratën më të bukur në botë. Paç shkëlqimin e Diellit çdo ditë të jetës shpirt i shpirtit tim Christian Meçi," përfundon ajo në postimin e saj në Instagram. Ndërkaq kujtojmë se bukurshja Vivian Canaj është vajza që me bukurinë e saj ka përfaqësuar vendin tonë në evente të ndryshme, duke përmendur këtu edhe pjesëmarrjen si imazhi i Valentino-s në Azi vitin e shkuar. Përqendrimi kryesor i modeles 22-vjeçare tanimë është vogëlushi Christian si dhe biznesi që ka hapur në Tiranë. Ajo nuk është vetëm një modele, por është e impenjuar edhe në fushën e drejtësisë. Canaj e konsideron drejtësinë të ardhmen e saj duke qenë se ka studiuar për të drejtë tregtare. Gjithashtu kujtojmë se modelja 23-vjeçare kurorëzoi lidhjen e saj 2-vjeçare me diplomatin Krivis Meçi në tetor të vitit të shkuar përmes një ceremonie madhështore. Dasma e shumëpritur e bukurshes shqiptare u mbajt në hotelin 'Rogner', ku të ftuar të shumtë u bënë pjesë e gëzimit të çiftit. Me interpretimin e këngëtareve Irma dhe Eranda Libohova është krijuar një atmosferë vërtet e këndshme tetorin e vitit të kaluar. Tashmë nën rolin e nënës, modelja bukurshje do të ketë një tjetër rol të rëndësishëm me të cilin do të kalojë pjesën më të madhe të kohës. Sa bukur të jesh nënë!




Shtatzënë dhe plot nur, Anjeza Shahini shfaqet e lumtur me barkun e rrumbullakosur

Këngëtarja detyrohet të heqë dorë nga zakoni i preferuar: Nuk është e lehtë, por ndihesh mirë kur e bën për diçka që ia vlen

Pamela Aliaj

Është një periudhë vërtetë e veçantë kjo e festave të fundvitit dhe shumë prej nesh mezi presin t'i festojmë nën një oxhak të ngrohtë me njerëzit më të dashur. Ky vit që pothuajse është drejt fundit për shumë prej nesh ka sjellë shumë ndryshime. Edhe për ata që janë larg vendlindjes nuk kemi se si të mos lëmë një vend të veçantë në vëmendjen dhe në kujtimet tona. Edhe për njerëzit e njohur që zgjodhën të jetonin larg Shqipërisë, ne herë pas here i sjellim në kujtesë jo vetëm me emocionet që ata lanë apo krenarinë që 'mbollën' në vendet e huaja duke na përfaqësuar denjësisht, por edhe për talentin e tyre të veçantë që do të mbetet gjatë në kujtesën tonë. Gjithë ky epilog i dedikohet një prej zërave më të dashur të muzikës shqiptare, e cila për arsyet e saj vendosi të largohet nga vendi duke nisur një jetë të re në Londër. Po flasim pikërisht për këngëtarën e njohur nga Tirana, Anjeza Shahini, e cila tanimë është në pritje të fëmijës së parë. Këngëtarja e njohur ka kohë që i ka munguar skenës muzikore, por nuk mungon me postime të herë pas hershme në rrjetet sociale. Vetëm para pak ditësh këngëtarja bëri publike lajmin se ajo po bëhet nënë. Këtë e ka konfirmuar vetë këngëtarja përmes një postimi në 'Instagram'. Por shtatzënia vjen me huqe të reja, me dëshira apo edhe me gjëra nga të cilat duhet të heqim dorë. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me këngëtarën, së cila gjatë kësaj periudhe, i është dashur të heqë dorë nga shumë gjëra. Shumë perso-



na nuk mund të vijnë normalisht ditën pa pirë në fillim një filxhan. Megjithatë kafeja për gratë në pritje të ëmbël nuk është e këshillueshme. Mesa duket edhe këngëtarja Anjeza Shahini do duhet të heqë dorë prej saj. Ajo ka publikuar një foto ku është duke pirë dekafeinato dhe krahas fotos ka shkruar: "Nuk është e lehtë të ndryshosh zakonet, por ndihesh mirë kur e bën për diçka që ia vlen," - përfundon këngëtarja. Anjeza prej kohësh jeton jashtë vendit së bashku me bashkëshortin e saj, diplomatin anglez Paul Edward Conolly. Dimër, ngrohtë, afër oxhakut me dekafeinato me një bebush që rritet brenda teje, një pritje më të ëmbël se kaq, përjashtuar zakoneve, nuk mund të kishte tjetër!

Zhvishet fituesja e 'Mis Grand Albania', Dashuria Bilaj: Ja pse e mora këtë vendim

Misi shqiptar pozon nudo në bregdetin e Vlorës

"Kjo është pjesë e të qenit artiste, prindërit më kanë mirëkuptuar"

Dashuria Bilaj është një artiste shqiptare që karrierën dhe jetën e ka ndërtuar në Kosovë. Prej vitesh është në tregun muzikor ndërsa këtë vit ajo ka fituar çmimin 'Miss Grand Albania'. Bilaj është rikthyer në Shqipëri për të dhënë një mesazh të fortë në lidhje me një çështje, e cila ka qenë gjatë gjithë kohës jo vetëm shqetësim për Shqipërinë, por edhe vendet fqinje. Këngëtarja ka zgjedhur që të ngrejë shqetësimin e ndotjes së bregdetit duke kërkuar të tërheqë vëmendjen nëpërmjet një seti fotografik nudo mes mbetjeve në bregdet. Ajo ka zgjedhur këtë mënyrë për të ndërgjegjësuar qytetarët që mos të ndotin më detin dhe lumenjtë si dhe institucionet që të marrin masa. Sipas saj ky guxim i tepruar i cili mund të paragjykohej duhet të shikohet në anën tjetër të medaljes, atë të fenomenit të ndotjes së plazheve

Enrik Mehmeti

Si lindi ideja e të pozuarit nudo duke patur si epiqendër ndotjen e bregdetit?

Pavarësisht se jetoj dhe punoj në Kosovë si dhe udhëtoj në vende të ndryshme të botës me koncerte, Shqipërinë e kam gjithmonë në zemër. Gati çdo vit pushimet e verës i kaloj në vende të ndryshme bregdetare në Shqipëri duke nisur nga Velipoja deri në Ksamil. Në këto udhëtime kam qenë e shoqëruar me miq kryesisht artistë nga Kosova apo dhe nga vende të tjera të botës. Të gjithëve u ka lënë mbresa bukuria e vendit tonë, sidomos jugu dhe bregdeti i tij, por shumica nuk kanë dashur të rikthehen për ndotjen e madhe në bregdetin Shqiptar. Mbeturina ngado të hedhura pa kriter në çdo cep. Nuk ka plazh që nuk është i ndotur qoftë me mbetje plastike apo materiale qelqi të hedhura në çdo cep. Kjo bën që t'i zbehet bukuria plazheve që aq shumë i mburrim. Shumë njerëz kanë hyrë në det dhe kanë dëmtuar këmbët me qelqe të hedhura, të tjerë ngjitur me çadrën kanë pasur dhe mbeturina të çdo lloji dhe të tjera me radhë. Ky imazh i keq bën që e gjithë ajo krenari të rrëzohet vetëm nga mbeturinat që i gjejmë në çdo plazh madje dhe në ato që rrallëherë shkelen nga pushues.

Pse kjo formë për të tërhequr vëmendjen?

Sepse në Shqipëri me aq sa kam




parë vetëm ekspremitetet tërheqin vëmendje. Kemi parë nisma të ndryshme nga shoqata në projekte të ndryshme, por që nuk kanë dhënë efekte të pritura, kemi parë që ka një ditë për pastrimin e plazheve, por dhe iniciativa të ndryshme, por deri tani asnjë nuk ka dhënë efekt. Duke qenë e vetme doja të jepja një kontribut kundër këtij fenomeni që shërmon plazhet, të cilat të tjerët na kanë zili, vendosa që të realizoj këtë mesazh nëpërmjet nudos artistike. Duke qenë në Shqipëri të pozosh nudo shikohet si diçka e rrallë dhe tërheq shumë vëmendje, fotografitë janë realizuar pranë dhe me mbeturinat reale që plazhet tona kanë, pjesë plastike apo qelqi që janë aty prej kushedi sa vjetësh.

Ke menduar se mund të paragjykohej?

Në çdo vend të botës nuditeti përdoret nga individë apo grupe për çështje të caktuara. Është e vërtetë që në Shqipëri apo dhe Kosovë kjo gjë mund të ketë një paragjykim por më e rëndësishme për mua është dhënia e mesazhit që dua të përcjell. Ata që i tërheq nuditeti





për mirë apo për keq shpresoj që të kenë dhe një ndërgjegjësimit në të ardhmen për t'i dhënë një

zgjdhje këtij problemi që në Shqipëri duket normal ndërsa në vendet e tjera të botës, nëse një

qytetar hedh mbeturina në bregdet mund të marrë gjoba të majme ndërsa këtu tek ne hidhen pa

problemin më të vogël.
Po familja çfarë mendon për fotot nudo?

Përderisa janë për një çështje të duhur kam dhe mbështetjen e tyre. Në fillim iu duk e çuditshme si





Ul fustanin para pasqyrës, Aurela Hoxha provokon duke nxjerrë gjoksin


Para pak ditësh modelja e njohur i habiti të gjithë me deklaratën e saj, duke thënë se ka "fobi" njerëzit me fytyrë të shëmtuar, duke zgjuar mjaft reagime negative. Gjithashtu Aurela Hoxha është akuzuar për shkak të pamjes së saj të jashtme, se i është nënshtruar bistorisë dhe tashmë del në ekran me një deklaratë të cilësuar si aspak të hijshme. Por, pas shumë reagimeve të kësaj deklarate, ajo ka vijuar me postimet e saj provokuese. Së fundmi është shfaqur në një postim mjaft provokues, ku fustani i ulur për pak sa nuk i nxjerr në shesh gjoksin. Provokuese, seksi dhe moskokëçarëse, e tillë është Aurela Hoxha.



© Enrik Mehmeti




© Enrik Mehmeti



© Enrik Mehmeti



© Enrik Mehmeti



© Enrik Mehmeti

mamit dhe babit si dhe kishin merakun e paragjytimeve. Duke menduar dhe faktin e të qenit artiste dhe kjo është pjesë e jetës së një artisti akoma më shumë kur përpiqet të përcjellë një mesazh pozitiv, më kanë mirëkuptuar.

Kush mendoni se është fajtor për këtë fenomen?

Mendoj që fajtor janë si ata që frekuentojnë plazhet dhe i hedhin të shkujdesur dhe deri te institucionet që nuk vendosin koshë për mbeturinat apo nuk i pastrojnë ato. Shumë të tjerë i hedhin nëpër lumenj duke mos u shqetësuar se përfundojnë në det. Plastika dhe qelqi janë mbeturina që nuk dekompozohen dhe për pasojë qëndrojnë aty për një kohë të gjatë. Të parët që duhet të ndërjegjësohen janë njerëzit që t'i ruajnë dhe t'i hedhin në vendet e caktuara. Dhe në vende të ndryshme të botës ka vende dhe plazhe, të cilat nuk kanë pika përkatëse, por askush nuk merr dhe i hedh shkujdesur ku të mundë, por i ruan dhe i hedh atje ku duhen.

Si mendon se do të jetë impakti i fotografive?

Duke qenë se Tepelena është një qytezë e vogël dhe të gjithë njihen me njëri-tjetrin mendoj se mund të shikohem ndryshe, paragjykohe m por s'kam ç'të bëj. Dikush kupton,



© Enrik Mehmeti



© Enrik Mehmeti

dikush jo. Fakti që jetoj mes Kosovës dhe vendeve të tjera ku shkoj për aktivitetet muzikore do e lehtësojë këtë paragjykim **Ishte i vështirë realizimi?** Duke qenë se në Shqipëri është shumë tabu realizimi i fotove të këtij lloji, realizimi kishte vështirësitë e tij.

Po për sa i përket impaktit të fenomenit?

Shpresoj që dikush ta mendoj dy herë përpara se ta kryej këtë

"krim", sepse për mua është i tillë. Nuk mendoj se u zhvesh Dashuria dhe nuk do hidhen më mbeturina, por të paktën, ndoshta kujtohen se dikush "protestoi" në mënyrën e tij për këtë çështje. Ndoshta nuk është shumë.

Cili është mesazhi i përmbledhur në një fjali?

Mesazhi im për të gjithë fansat, qytetarët, pushuesit, institucionet është: Të mbajmë plazhet e pas- tra.



© Enrik Mehmeti

Pas modeles, habit moderatori shqiptar: Njerëzit e shëmtuar janë të këqij dhe të palumtur

Cacophobia', e quajtur ndryshe frika nga e shëmtuara qenka një nga fobitë e përhapura, por jo të shumëpërfolura ditët e fundit. Vetëm dy ditë më parë ishte modelja Aurela Hoxha, ajo e cili i shokoi të gjithë me deklaratën e bërë në një emision sa u përket njerëzve më pak të bukur. "Kam frikë nga njerëzit e shëmtuar", ishin fjalët e modeles, të cilat bënë bujë në media, e padyshim përgjigja nga ana e publikut ishte mjaft negative në drejtim të saj. Kësaj radhe është një personazh tjetër që ka një deklaratë të përafërt me të. Bëhet fjalë për moderatorin shqiptar Kelvi Kadili, i cili në emisionin e tij "Flakë fare", në një intervistë me gazetaren Aulona Musta, e pyeti atë nëse i gjykonte njerëzit nga pamja e jashtme. "Bukuria është relative, është me rëndësi të ndjesh mirë me veten tënde. Mendoj që ka njerëz të bukur e të shëmtuar, që mua më duken të tillë, por s'do guxoja kurrë t'ia thosha këtë gjë, sepse është thjesht përshtypje e imja", ishin fjalët e Aulonës. Ndërsa moderatori u shpreh hapur duke thënë se të shëmtuarit janë njerëz të këqij. "Fobia ime më e madhe janë njerëzit e shëmtuar. Ata janë të palumtur dhe janë njerëz të këqij", tha moderatori shqiptar. Të jetë kjo një trend i fundit i çuditshëm apo njerëzit parapëlqejnë fasadën tanimë e jo brendinë?



"Sot jam 17 vjeçe!", vajza e ministrit merr tortën e çuditshme për ditëlindje

Të gjitha për festat e ditëlindjeve presin përveç dhuratave, edhe një tortë të veçantë dedikuar atyre. Por, kjo gjë s'ka ndodhur me vajzën e ministrit shqiptar. Për ditëlindjen e saj të 17-të, ajo ka marrë një tortë të habitshme. Vajza e ministrit Niko Peleshi është surprizuar nga miqtë për ditëlindje para pak ditësh, por ajo që ra më tepër në sy ishte vetë torta e jo vajza bukuroshe. Aleksia Peleshi, e veshur me një fustan të zi, që i nxirrte në pah linjat e saj perfekte, dukej shumë simpatike. Torta e përgatitur me fytyrën e Ard Daulxhiut, personazhi që u bë shumë i njohur në emisionin "Zonë e Lirë" e më pas në të gjithë rrjetin e ka bërë të qeshë pafund vajzën e Peleshit. Ç'të jetë arsyeja që e lidh me këtë personazh? E veçantë në llojin e saj si tortë, vetëm për ata që ia dinë kuptimin.





Enca "kopjon" Oriola Marashin me pamjen e fundit, ç'po ndodh mes tyre?

Ato janë dy nga anëtarët e OTR më të përfolura, ku njëra prej tyre tash më nuk është më pjesë e grupit. Enca është larguar me bujë nga grupi i Noizyt, por duket se ka nën vëzhgim zëvendësuesen e saj. Oriola Marashi para disa ditësh u shfaq bionde, por pas postimeve të saj, nuk vonoi edhe Enca të ndryshonte pamje. Me anë të disa postimeve, këngëtarja ka kërkuar mendimin e fansave të saj se si i duket ndryshimi i saj. Të jetë ky një provokim i bërë drejtpërdrejtë Oriolës, apo është trend i dimrit flokuri biond?



Pas ndarjes me Seldin, Mimoza "në krah" të reperit të njohur?

Edhe pse nuk ka kaluar shumë kohë nga dita kur Mimoza Shkodra dhe Seldi Qalliu pranuan publikisht ndarjen e tyre, ende vijojnë thumbimet e ndjekësve të të dy këngëtarëve. Së fundmi në mediat rozë ka qarkulluar lajmi se Mimoza do të sillte bashkëpunim me reperin e njohur Gold Ag, duke zëvendësuar kështu ish-partnerin e saj, me të cilin ishte fejuar dhe ka pasur disa duete më parë. Kaq mjaftoi që edhe të përfitej se përtej bashkëpunimit në muzikë, mes tyre ka lindur diçka tjetër. Megjithatë, Shkodra ka vendosur të reagojë dhe të tregojë se si qëndron e vërteta. Ajo është shprehur se për momentin nuk do të ketë bashkëpunim me asnjë këngëtar tjetër, por për më vonë nuk mund të flasë me siguri. "Një informacion për ju fansat dhe miqtë e mi. Nuk do të kem për momentin bashkëpunim me askënd, më vonë patjetër që do të ketë... Së shpejti do të dalin projektet e mia 'single' për ju. Kjo është vetëm një foto e bërë gjatë xhirimeve festive, por pse jo në të ardhmen nuk i dihet, sigurisht që me shumë kolegë do të kem bashkëpunime", - ka shkruar këngëtarja. Mjafton me kaq për gojë e ligë?



Dje/në 'Deutsche Welle'

S'ka anëtarësim të Serbisë në BE, pa njohur më parë Kosovën

Nga Peter Beyer

(vijon nga faqja 1)

...të ketë anëtarësim të Serbisë në BE pa njohje të Kosovës.

Deutsche Welle: Ju ishit në Beograd para pak kohësh dhe thate në një intervistë për agjencinë serbe të lajmeve, 'Tanjug' se Serbia nuk mund të hyjë në BE pa njohur Kosovën. E thate vërtetë kështu, apo ju cituan gabim?

Peter Beyer: Kjo nuk është ndonjë gjë e re. Unë thashë se nuk mund të ketë anëtarësim në BE pa njohje të Kosovës. Për realizimin e kësaj ka disa modele, e di që nuk është e lehtë. Ka qenë një parakusht që u vu para se të nisnin bisedimet. Çdokush e kishte të qartë që në fillim. Prandaj më habit vala e madhe e reagimeve që erdhin pasi e thashë këtë.

Besoni se kjo do të ndodhë me të vërtetë?

Kjo nuk është çështje besimi, por është çështje se si mund të arrihen përparime thelbësore në procesin e dialogut mes Serbisë dhe Kosovës dhe se si mund të përparohet në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE. Jo më kot në negociatë është futur edhe kapitulli 35. Në se duan seriozisht të hyjnë në BE, të dyja palët duhet të hyjnë në bisedime. Nuk është e lehtë, por kur ke një qëllim përpara, nganjëherë duhet dalë jashtë kuadrin zakonshëm.

Kryeministria e Serbisë, Ana Brnabic, tha të hënën në Berlin se Serbia nuk do ta njohë kurrë Kosovën si shtet.

E kuptoj se përse zonia kryeministritë Brnabic e thotë këtë. Është ende herët të flitet për format konkrete se si do të bëhet njohja. E di që kjo do të kërkojë edhe ndryshimin e kushtetutës nga ana e Serbisë. Prandaj edhe bëjmë mirë që ta kujtojmë herë pas here, se cilat janë kushtet e anëtarësimit në BE. Kjo ishte edhe arsyeja se përse unë e thashë në intervistën time me 'Tanjug'-un, se përse dialogu midis Serbisë dhe Kosovës, përfshirë edhe njohja e Kosovës, është pjesë integrale shumë e rëndësishme e hapave që duhen bërë në rrugën drejt BE-së.

Në median serbe dialogu është shpallur që tani i vdekur. A do ta shihnit edhe ju kështu?

Jo, natyrisht. E shoh që nuk po bëhen përparimet thelbësore në këtë pikë. Kjo më shqetëson, por nuk mund të them se dialogu ka vdekur. Por unë apeloj te të gjithë përgjegjësit, dhe këtu hyjnë jo vetëm pala serbe dhe pala kosovare, por edhe zonia Mogherini, që të mbledhin forcat e ta shohin me kujdes edhe njëherë rrugëtimin që kanë për të bërë bërë dhe ta vazhdojnë atë. Pra, nuk është kurrësi i vdekur, ndoshta ka nevojë sërish për një impuls të ri, ky impuls ndoshta mund të vijë nga Gjermania. Këtë unë nuk e di, por detyra ime ishte t'ua kujtoja. **Serbia është shqetësuar që pikërisht në këtë moment, kur edhe dialogu ka ngecur, nisi procesi i krijimit të Ushtrisë së Kosovës.**

Unë e kuptoj shqetësimin e Serbisë, por askush nuk ka përse ta ndiejë veten të kërcënuar nga



Ushtria e Kosovës. Apeli im për të dyja palët: Ruajeni qetësinë dhe përqendrohuni te temat. Është në interes të përbashkët dhe në interes të BE-së dhe të Gjermanisë që këto vende të shkojnë mirë me njëri-tjetrin, në fund që të dy do të jenë anëtarë të plotë të BE-së. **Ushtria e Kosovës kërkoi 300 milionë euro investim. A janë këto para të investuara mirë, kur Kosova mund të ndihmohet fare mirë edhe nga partnerët e shumë ndërkombëtarë që ka?**

Ne këtë po e diskutojmë aktualisht edhe në Europë, që të krijojmë një ushtri evropiane. Kancelarja gjermane dhe ministri i Jashtëm Heiko Maas e kanë theksuar në ditët e fundit se na duhet një ushtri. Por në fund të ditës çdo vendi do t'i duhet vetë të kujdeset për sigurinë e vet, por tekefundit është edhe çështje e krenarisë kombëtare që të jesh në gjendje ta mbrosh vetë sigurinë e vendit tënd. Prandaj unë mendoj se ky është një zhvillim i mirë, por që duhet të ecë ngadalë dhe shpresoj që ushtria të mos jetë e detyruar të angazhohet për mbrojtjen e territorit.

Një propozim për zgjidhjen e çështjes së konfliktit e që vjen

nga të dyja palët është ndryshimi i kufijve. Këtë e mbështet Amerika kurse Gjermania është rreptësisht kundër. Përse?

Sepse ne mendojmë se këmbimi i territoreve, sado i strukturuar që të bëhet, mund të prishë stabilitetin e rajonit. Po përmend Republika Srpskan, Bosnjë-Hercegovinën, por ka edhe vende të tjera. Ky është një shqetësim që ndajmë edhe partnerët amerikanë. Pra, nuk është se ata janë tërësisht pro këtij propozimi. Pra, kur thuhet se këtë propozim e mbështet edhe amerikanët, duhet parë se sa aktivë janë. Edhe në takimet që pata në rajon, përveç presidentit Thaçi, nuk gjeta askënd që ishte pro këmbimit të territoreve. Veç kësaj mendoj se në shekullin 21 i kemi lënë ndarjet e territoreve në bazë të përkatësisë etnike. Por, edhe nëse ky propozim do të ndodhte me të vërtetë: Janë vetëm 35 mijë serbë në veri të Kosovës që do të ishin të prekur nga ky kompromis. Por çfarë do të ndodhë me serbët që janë në pjesë të tjera të Kosovës? Ata janë më të shumtë në numër. Pra, ky propozim nuk është kurrësi zgjidhje.

Në median serbe thuhet se Gjermania, në fakt, për shkakë të

politikës së brendshme nuk është e interesuar në anëtarësimin e Serbisë në BE. Sa e vërtetë mund të jetë kjo?

Janë thashetheme. Në biznesin politik, sidomos në Ballkan, ka shumë shpesh thashetheme, si për shembull, për çështjen e liberalizimit të vizave. Kur isha në Kosovë, takova politikanë që thoshin se na është premtuar liberalizimi i vizave brenda vitit. Nuk e di se kush mund t'ua këtë thënë. **Pra, ju nuk mendoni se do të ketë liberalizim vizash brenda këtij viti, megjithëse Komisioni dhe Parlamenti European kanë dhënë dritën e gjelbër?**

Ne jemi në një proces. Është e vërtetë që Komisioni European dhe Parlamenti European janë shprehur për liberalizimin e regjimit të vizave. Tani e kanë radhën 27 vendet anëtare që ta komentojnë këtë dhe të pozicionohen. Në fund do të jetë Këshilli i ministrave të BE-së, që do të vendosë. Por për këtë duhen dërguar në Bruksel të gjitha qëndrimet e 27 vendeve. Gjermania nuk ka dalë ende me një pozicion. Për këtë duhet të bien dakord Ministria e Brendshme me atë të Jashtëme. Se kur do të bëhet publik ky

qëndrim, kjo nuk dihet. Por nuk besoj se do të ketë një vendim brenda këtij viti, mendoj se kjo do të ndodhë vitin e ardhshëm.

Pas zgjedhjeve të Europës?

Ç'është e vërteta duhet të jemi realistë. Unë për vete jam me gjithë zemër për liberalizimin e vizave. Por këtë nuk e vendos unë, por përfaqësuesit e 27 vendeve anëtare të BE-së. Prandaj është e vështirë të jepet një datë. Kjo më duket edhe e rrezikshme. Por unë për vete nuk pres vendim para zgjedhjeve për Parlamentin European.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, gëzon një reputacion të lartë në Ballkan. A ka shanse që tani që ajo do të tërhiqet nga kryesia e Partisë të angazhohet me shumë aty?

Kancelarja, për sa kam pasur ta shoqëroj gjatë këtyre viteve, është shumë e interesuar në përparimin dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Ajo është shumë e informuar, edhe pse nuk shprehet gjithnjë në publik. Dëshira ime është që ajo ta dhe ta përfaqësojë edhe më me forcë pozicionin gjerman dhe që të ndërhyjë pak më shumë në mënyrë konstruktive. Ajo e ka bërë këtë edhe më parë në të kaluarën, megjithëse ndoshta më pak në vitin e kaluar dhe këtë vit, sepse vështrimi i saj ishte më i fokusuar në politikën e brendshme. Por guxoj të parashikoj se në të ardhmen e afërt do ta përjetojmë ndoshta të përzihet më shumë.

Ç'duhet të bëjnë krerët e Ballkanit për ta bërë me të mundshëm angazhimin e Kancelares në Ballkan?

Apeli im është të bëjnë gjithçka në interes të vetin. Prandaj ne na duhet një agjendë pozitive dhe përparime, dhe jo diçka që politika që ashpërsojnë fronte.

A do të ndryshojë politika ndaj Ballkanit kur të përfundojë era e Merkelit?

Era e Merkelit nuk ka përfunduar akoma. Ne shohim se çfarë do të ndodhë pas saj. Do të kemi dikë tjetër në krye e të partisë, prandaj Kancelarja në fillim do të bëjë punën e saj si më tej, ndoshta do të ketë më shumë kohë që të merret me Ballkanin Perëndimor, kjo si mesazh pozitiv. Ne në Bundestag, në CDU/CSU kemi një grup joformal për Ballkanin Perëndimor, që e ka krijuar Andreas Schockenhoff, i cili para ca vitesh vdiq shumë më parakohe. Këtu mblidhen të gjithë ata që janë raportues për Ballkanin Perëndimor në të gjitha Komisionet Parlamentare. Ne takohemi, angazhohemi, sepse besojmë në të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin European. Dhe këtu luan një rol shumë të fortë edhe Grupi Parlamentar CDU/CSU, çfarë është diçka e rrallë, sepse grupet e tjera parlamentare nuk e bëjnë në mënyrë kaq të strukturuar ndër vite, sic e bëjmë ne. Ne ndërhyjmë në mënyrë kritike dhe në interes të mirëkuptuar të njerëzve që jetojnë në Ballkanin Perëndimor dhe këtë do ta bëjmë edhe në vijim e ndoshta më me forcë.

Opinion *i* Ditës

A po "shikon" Europa më mirë me ambasadorin e ri?

Nga Blendi Fevziu

(vijon nga faqja 1)

... zonja Vlahutin, ambasadori i ri, në vetëm 8 javë ka arritur të shohë dhe lexojë gjëra që duket se janë thelbësore në këtë vend. Dhe për të cilat deri më sot, ka folur kryesisht ambasadori amerikan në Tiranë, kanë folur struktura në Bruksel, por thuajse asnjëherë përfaqësia diplomatike europiane në Tiranë.

Ambasadori i ri e vuri theksin tek një problem që po bëhet sfilites në këtë vend dhe që së fundmi, po përvijohet edhe si kushti bazë për hapjen e negociatave në qershor: lufta kundër krimit dhe lidhjet e krimit me politikën!

E para, Soreka deklaroi se për të luftuar krimin dhe mafian ka një formulë që ka dhënë rezultate konkrete kudo në botë: "Ndëq Paratë"! Ai e përsëriti këtë 4 herë, sikur të kishte më shumë informacione se sa ne vetë për investimin e parave të pista të kanabisit dhe drogës në tregun e pasurive të patundshme; në atë të ndërtimit dhe siç dyshohet edhe në atë të PPP-ve. Soreka ka plotësisht të drejtë.

Nëse paratë e paligjshme të krimit, të përfituara nga aktivitet kriminal në Shqipëri apo në Europë, do të investohet në këtë vend, mafia do të jetë investitori kryesor në Shqipëri dhe kjo është dëshpërimisht e frikshme. Nga ana tjetër, para dhe pasurimi është bërë aktiviteti i parë i krimit dhe ky i fundit nuk mund të goditet veçse duke e ndjekur atë nga ky drejtim. Dhe duke iu prerë burimin e parave!

E dyta, Soreka deklaroi se lidhjet e politikës me krimin motivohen kryesisht nga nevoja e politikës për vota dhe nga administrimi që mafia ju bën shpesh atyre përmes kontrollit të territorit dhe kërcënimit të popullatës. Për të prerë lidhjet e politikës me krimin, më e thjeshta është ta bësh ta pamundur trafikun



e votave. Dhe të ndëshkosh rreptë jo vetëm atë që manipulon votën, por edhe atë politikan që tenton ta negociojë atë me krimin.

E treta, Soreka deklaroi se lufta ndaj krimit, nuk duhet reduktuar vetëm në kapjen e kriminelëve, por duhet të shtrihet deri tek dënimi i tyre dhe përtej, tek bllokimi i kontakteve të tyre nga burgu me botën e krimit jashtë. Për këtë ai solli si një shembull suksesi ligjin 41/Bis, që ndryshoi në mënyrë radikale situatën e krimit në Itali. Ky ligj autorizon izolimin e plotë të kriminelëve të rrezikshëm duke mos lejuar komunikimin e tyre me jashtë burgut. Zbatimi i tij është thjeshtë test që do tregojë se sa e pavarur është politika në Shqipëri nga krimi.

Të tria këto përfundime, qenë deklarata që nga ambasada e BE nuk ishin dëgjuar në Tiranë. 16 vjet

më parë, ambasadori amerikan Xhefri i ishte drejtuar kriminelëve në publik me deklaratën: "Baronë të krimit ju njohim, do t'ju ndjekim kudo që të jeni!"

Që nga ajo kohë lufta kundër bandave, krimit dhe përfshirjes së tyre në politikë ka qenë thjeshtë ekskluzivitet i ambasadorëve amerikanë. Siç ndodhi në vitet e fundit me L. Tashmë, duket se BE ka nisur të shohë atë problem që amerikanët e shihnin prej vitesh. Dhe që është një ndihmë reale për Shqipërinë. Ardhja e Sorekës në krye të delegacionit jep edhe një garanci personale në këtë drejtim.

Ai duket në modelin e ambasadorëve që janë më shumë njerëz të aksionit. Siç deklaroi, ka hipur vetë në avionin e Guardia Di Financés për të parë situatën e kanabisit në Shqipëri. Situatë për të cilën zonja Vlahutin nuk foli qoftë edhe një

herë. Ai vjen nga një karrierë si njeri i ligjit dhe Prokuror i Antimafias në Sicili. Ka qenë atje në një periudhë lufte të hapur mes mafias dhe ligjit, ku ka parë shumë nga kolegët e tij që kanë humbur jetën në këtë betejë. Por ka pasur fatin të shohë edhe falimentimin publik të krimit në raport me shtetin.

Ndaj ai e di, se një vend ku banditët dhe kriminelët lëvizin lirshëm në mes të qytetit dhe ku trafikantët zgjidhen deputetë nuk është një vend normal.

Tani kur veç ambasadës së SHBA edhe kjo e BE shton një zë më tepër kundër krimit; dhe kur në Shqipëri, për fat të keq, besimi tek ambasadat e huaja është më i madh se sa ai tek drejtësia dhe politika, çdo presion që vjen prej tyre është një bonus më shumë për një Shqipëri më normale dhe pa lidhje të krimit me politikën!

HOROSKOPI

DASHI
Duhet të bëni më të mirën tuaj në punë nëse duhet të fitoni respektin e atyre që ju rrethojnë. Mos jini kategorik dhe të prerë në çdo gjë. Sa i përket dashurisë, jo gjithçka është në formën e duhur.

DEMI
Nëse doni të merrni pjesë në lloto, fatin e keni në dorën tuaj. Në punë do të përfiton nga rastet që do t'ju vijnë. Në dashuri do të konkretizoni një dëshirë, të cilën e keni ëndërruar prej kohësh.

BINJAKET
Do të ndiheni të shpërqendruar dhe nuk do të mund të merrni iniciativë të rëndësishme. Në mbrëmje nëse jeni vetëm do të programoni një mbrëmje shumë emocionale. Me punën tregoni kujdes.

GAFORJA
Sot yjet ju këshillojnë që në çështjet e dashurisë të veproni në bazë të instinktit tuaj, sepse do të jeni shumë intuitiv. Në punë duhet të jeni seriozë për të shmangur ndonjë zhgënjim me pasojë.

LUANI
Suksesi do t'ju udhëheqë në të gjitha vendimet që do të merrni. Në punë do të kapni më shumë mundësi të reja. Edhe promovimet nuk përjashtohen. Sa i përket dashurisë, ndiheni shumë mirë vetëm.

VIRGJERESHA
Diçka mund t'ju bezdisë sot prandaj bëni kujdes me miqësitë e sapokrijuara. Në punë mund të vijnë disa pagesa të papritura. Një investim i vjetër do të sjellë rezultate shumë të mira.

PESHORJA
Një problem i vogël mund të dalë në vendin tuaj të punës. Falë kredibilitetit që keni gjithçka do të kalojë si me magji. Në dashuri do të merrni lajme të mira të cilat do ju ndryshojnë ditën.

AKREPI
Dita do të jetë e mbushur me surpriza të këndshme. Do të njihni miq të rinj që do t'ju bëjnë gjithçka do të kulturën dhe elokucençën e tyre. Në fushën e ndjenjave partneri do t'ju habisë me originalitetin e tij.

SHIGJETARI
Duhet të dëgjoni këshillën e njerëzve që ju duan të mirën dhe që ju vënë përballë realitetit, kështu që merrni parasysh sugjerimet tuaja. Parashikohet që të bëni një njohje të re.

BRICJAPI
Një lidhje dashurie pritet që të ketë ulje ngjritje. Përpunoni që të ruani qetësinë në një situatë nervozizmi përmundshme do të kaloni në probleme të paparashikuara. Me çështjet e ekonomisë jo gjithçka po ecën mirë.

UJORI
Parashikohet të keni fat në fushën e dashurisë. Një njohje e re pritet të rezultojë afatgjatë. Në vendin e punës kushdojini më shumë vëmendje një detyrë të cilën e keni lënë pas dore prej shumë kohësh.

PESHQIT
Yjet e favorizojnë shenjën tuaj sa i përket karrierës. Nëse jeni duke planifikuar që të ndërmerrni një iniciativë të re do të fat maksimal që gjithçka të shkojë në mënyrë të suksesshme.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Mërgim Mavraj, kapiteni i Shqipërisë në ndeshjen ndaj Skocisë

Mavraj: Kemi pësuar gola për fajin tonë, të përmirësohemi

Mbrojtësi dhe kapiteni i Kombëtares shqiptare të futbollit, Mërgim Mavraj foli në konferencë për shtyp para ndeshjes kundër Izraelit. Në fjalën e tij, kapiteni i Kombëtares kuqezi tha: "Përgjegjësia është e çdo futbollisti në fushë. Goli që pësuar në

Izrael, i pari, ishte gabim, pasi nuk e treguam veten të aftë në atë moment. Trajneri ka të drejtë. Kjo na ndikoi ndeshjen e fundit. Nëse përmirësohemi në këtë pjesë, besoj se kemi gjasa të ia dalim. Shumë e vështirë të kemi një recetë se si mbrohet porta më mirë. Duhet të shmangim gabimet individuale, sepse na kushtojnë pikë. Nuk kemi pasur edhe fatin me vete. Në të kaluarën kemi treguar veten në

mbrojtje. Individualisht duhet të bëjmë më shumë. Duhet vëmendje e jashtëzakonshme në ndeshje. Duhet të jemi të përqendruar në momentet e duhura. Në këto ndeshje të rëndësishme, goditjet standarde kanë fitu-

ar shumë vlerë. Stërvitja gjatë javës është tjetër gjë në krahasim me ndeshjet. Do të përpiqemi të përmirësohemi. Kur jemi në stadium me 40 apo 50 mijë spektatorë, nuk mund të themi që një lojtar, ose kapiteni, apo lideri

kanë gabim. Nuk ka dallim kush është kapiteni. 11-të 'ushtarë' jemi në fushë. Nuk jam unë i vetmi, jemi të gjithë për një dëshirë e qëllim, për të mos pësuar. Nuk është garanci që po nuk fole, nuk do ta pësosh. Du-

het ndihma e të gjithëve. Nuk mund të garantojmë fitoren. Për të fituar në këto nivele, duhet të mbrohesh maksimalisht, por me dëshirë dhe vullnet të shënojme. Të gjithë të mbrohemi dhe të gjithë të fitojmë. Shanset rriten kështu. Besojmë te fitorja? Nëse nuk do të besonim nuk do të luanim fare", deklaroi Mavraj në konferencën për shtyp.

Liga e Kombeve, Shqipëria luan shanset e fundit ndaj Skocisë në "Loro Boriçi" të Shkodrës

Panuçi: Vuaj brenda meje këtë situatë, duhet të fitojmë

Italiani pranon se Shqipëria i ka komplikuar vetë gjërat



Jeton Selimi

Kristian Panuçi ka deklaruar në konferencën e fundit për shtyp në prag të takimit kundër Skocisë në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës, se Shqipëria do të futet në fushën e lojës për ta fituar këtë sfidë, fitore që do të zhbente disi këtë edicion eliminator të Ligës së Kombeve, ku kuqezi injektë e drejtuar nga tekniku italian, kanë zhvilluar një performancë të dobët. Panuçi deklaroi se formacionin do ta përcaktojë vetëm përpara ndeshjes, ndërsa nga lojtarët kryesorë, ai që shqetëson është Eros Grezda, që ka vuajtur pasojat e një dëmtimi. Në konferencën për shtyp, i pranishëm ka qenë edhe kapiteni Mavraj, që ka pranuar kritikën e trajnerit ndaj skuadrës dhe ka deklaruar se ndaj Skocisë, Shqipëria ka nevojë për 11 kapitenë në fushën e lojës.

Probleme në mbrojtje, por edhe në sulm. Çfarë ka menduar Panuçi për nesër (sot)?
Ndeshja duhet punuar për të shënuar. Në Izrael kemi pasur raste, pavarësisht finalizimit. Kemi taktika që do të përshatën me ndeshjen. Shpresojmë në fitore. Që kur kam qenë këtu, i kam inkurajuar lojtarët. Pyetni kapitenin, nuk i kam kërkuar të mbrohen, por gjithmonë me ekuilibër, i kam kërkuar që të luajnë sa më shumë ofensiv, nesër do t'i kërkoj të fitojnë.

A do të jenë të gatshëm Grezda dhe Ndoj?
Grezda është stërvitur gjithë javën, dje ka kërkuar të luajë. Ndoji mendoj se ka ende disa probleme.
Balaj do të jetë nga minuta e parë, pasi luan në shtëpinë e tij?
Do e shohim nesër (sot), por nëse e vendos marrja pjesë e tifozërisë shkodrane nëse luan ai, atëherë do të jetë shumë mirë.
Viti 2018 ishte më i keqi për

Shqipërinë në 10 vitet e fundit.
Është e vërtetë që është vit i keq. Duhet ta përmbysim situatën, por di që përveç Kosovës dhe Ukrainës, ku ishim pak konkurrues, në ndeshjet e tjera kemi pësuar në goditje standarde. Nuk është një moment pozitiv për ne.
Si mund të fitohet ndaj Skocisë?
Duhet një gol më shumë, kaq. **Keni kritikuar komunikimin në skuadër.**

Është e vërtetë, skuadra nuk komunikon shumë. Duhet ta bëjmë më shumë, këtë e dinë edhe lojtarët. Nëse arrijnë ta bëjnë, do të jetë shumë mirë. Shpresojmë që nesër të shohim cunat që të flasin më shumë, do i ndihmojë shumë me rezultat.
Si do i zëvendësoni Bashën dhe Hysajn?
Do i ndërroj me 2 lojtarë të tjerë. Formacionin do e shihni nesër (sot) në fushë. Duke shpresuar të mos gabojmë.



Do jetë fat stadiumi "Loro Boriçi"?
Nuk është punë fati, se me Italianë humbëm. Shpresoj që këtë radhë të në sjellë pak fat.
Skocia ka shumë mungesa gjithashtu...
Ne kemi hedhur në erë një grup, djemtë duhet ta kuptojnë e të ndërgjegjësohen se është puna jonë. Kemi bërë një ndeshje të mirë në Izrael, por kthym me 0 pikë, e vërtetë që gesh, pro brenda meje jam zjarr, nuk më pëlqen. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm për situatën.
Si është situata në ekip, të vjen keq që skuadra u dorëzua në Izrael?
Situata nuk është e mirë dhe djemtë e dinë që ka pasur shumë ndryshime. Duhet të ketë shumë vëmendje në ndeshjen që vjen. Në Izrael skuadra nuk u dorëzua, për 90 minuta ndoshta ka bërë ndeshjen më të mirë. Për 90 minuta kemi bërë lojë me cilësi, por nuk arritëm të futnim topin në rrjetë. Edhe duhet të mos harrojmë që goli i parë me Skocinë është pozicion jashtë loje, përveçse është autogol. Ekipi nuk ka pësuar gol në asnjë aksion loje normal deri tani.



E quajmë "pensionist", Wenger tërbohët me gazetarët

Arsen Wenger u larë nga kreu i Arsenalit pas plot 22 vitesh si trajner i "Topçinjtve" dhe tashmë po pret oferta nga klubet europiane, pavarësisht se shumë mendojnë se francezi ka mbaruar dhe tashmë duhet të dalë në pension njëherë e mirë. "Unë nuk ndihem ende si pensionist, prandaj jam i acaruar", tha Wenger për "BeIn Sports". "Unë jam një konkurrent dhe futbollit më mungon. Nuk kam mbaruar. Njerëzit gjithmonë duan t'ju kritikojnë dhe të flasin keq. Po më quajnë pensionist dhe të mbaruar, por do t'i vërtetoj të gjithëve të kundërtën. Një avantazh që unë kam nga 35 vjet në lojë është të shkëmbej atë që di me njerëz të tjerë dhe nëse nuk e bëni këtë atëherë jeta është e padobishme. Ju nuk duhet të largoheni nga kjo botë pa u përpjekur t'i jepni diçka popullit", - u shpreh Wenger.

Kombëtarja U-21 mposht Maltën 2-0

Gol dhe penallti e fituar, Hebjaj shkëlqen me Shpresat

Shqipëria U-21 mposhti Maltën U-21 me rezultatin 2-0 në takimin miqësor të zhvilluar në "Selman Stërmasi". Një dominim i skuadrës kuqezi që arriti të gjente 2 herë rrugën e rrjetës me anë të Rubin Hebjajt dhe mesfushorit të Shkëndijës së Tetovës, Imëri, i cili ktheu në gol penalltinë e fituar nga shkodrani i Partizanit.

Në pjesën e dytë, rritmi i lojës ra ndjeshëm, teksa të 2 trajnerët kryen zëvendësimet të shumta, që ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë tek loja. Vlen për t'u përmendur aktivizimi i mesfushorit Esat Mala, i cili tronditi

traversën në pjesën e dytë, falë një goditjeje mjeshtërore. Skuadra mike provoi të shënonte te paktën një gol në fundin e ndeshjes, por hasi rezistencën e portierit Dajsinani që ishte në një formë të mirë.

Habit presidenti i Milanit


Skaroni: Më mirë tri kualifikime në Champions sesa titullin kampion

Presidenti i ri i Milanit, Paolo Skaroni, ndryshe nga pjesa e tifozëve që kërkojnë tituj dhe trofe, është i mendimit se më shumë vlerë kanë 3 kualifikime radhazi në Ligën e Kampionëve dhe këtë e ka zbuluar në një intervistë për mediat italiane. Sakaq, ai ka folur edhe në lidhje me merkaton, duke pranuar se i pëlqen Ibrahimović, por që nuk ka gjë në dorë ai

personalisht. "Në futboll duhet të ngjitesh paralelisht dy male, ku njëri është sportiv, e tjetri ekonomik. Të dy janë të lidhur me "Pair Play-n financiar". Që të sjellim sërish kampionë të mëdhenj këtu, duhet të shohim nga Amerika dhe Lindja. E adhurjo Ibrahimovićin, por nuk ven-

dos unë për transferimet. Juventus është i vetmi ekip që po ecën në rrugën e klubeve angleze dhe duhet marrë shembull. Për mendimin tim, më mirë do të ishte të kualifikohesh 3 herë në Champions sesa të fitosh një kampionat", u shpreh presidenti.

Fjalëkryqi (1)



- 39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- 41. Kalimi në ekstreme.
- 42. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
- 44. Si i gjithë .
- 47. Kush e thotë lutet.
- 48. Kufij elementi.
- 49. Ishte nyja që preu Alekdandri i Madh.
- 50. Një pjesë e titanëve.
- 51. Mund të jetë kundërmuese.
- 52. Pak titanike.

VERTIKAL

- 1. Si i përshtatëshëm.
- 2. Mund të jenë fetare.
- 3. Ai i kuq e ka një huq.
- 4. Pak analogji.
- 6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
- 7. Një hyrje të oazit.
- 8. Arte pa re.
- 9. Arthur që qe dramaturg.
- 10. Janë boshte.
- 12. Michelangelo regjisor.
- 14. Mund të bëjë stil të lirë .
- 16. Ishin monedhe te Tobias.
- 17. Eshhtë bas me katër tela.
- 18. Pak efikasitet.
- 22. Eshhtë marrëveshje me nota.
- 25. Ishte babai i Akilit.
- 26. Fillojnë nazet.
- 27. Një krye të kuadrove.
- 29. Eshhtë faqe muri.
- 30. Një apendisit i menjëhershëm.
- 35. Kurosawa që qe regjisor.
- 36. Vriten nga espada.
- 37. Eshhtë shtet aziatik.
- 38. Edouard piktor.
- 40. Një transporti është kamioni.
- 45. Uni i Freud.
- 46. Një cigan.
- 47. Fundi i një samurai.

HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë kursimi.
- 5. Ylli i Nostradamus.
- 8. Tamam pa kufij.
- 11. Ross këngëtare.
- 13. I lashtë.
- 15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- 19. Kufijtë e lëvizjes
- 20. I ka tek plepi.
- 21. Paguhen për shërbim.
- 23. Fillojnë lejen.
- 24. Kufizojnë trotuarët.
- 25. Bëjnë karrierë në parti.
- 27. Thahet me bonifikim.
- 28. Mund të jetë unik një i tillë .
- 29. Preka komik shkordran.
- 31. Fund dhjetori.
- 32. Fillojnë aksionin.
- 33. Ente Operate Tiranë
- 34. Agjencia Ajrore Durrës.
- 36. Një pjesë e dimensioneve.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Fillojnë panikun.
- 3. Gibson aktor.
- 5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- 9. Mund të jetë trofe.
- 11. Janë vendet si Katari
- 14. Maureen që qe aktore.
- 16. Janë kundërmuese.
- 17. Mund të fitojnë etapa.
- 20. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Një thirrje
- 26. Janë ministritë.
- 27. Një rrugë në Paris.
- 28. Markë cigareje.
- 29. Eshhtë ngjinja.
- 32. Ricciarelli soprano.
- 33. Fillojnë sefte.
- 34. Ente Ekonomike Sarandë.


- 35. Mbyllin një ditar.
- 36. Satelit i Jupiterit
- 37. I ka tek Luani.
- 38. Boldi komik italian.
- 42. Eshhtë kolana në filma.
- 43. Kush e thotë lutet.
- 44. Oxa këngëtare.
- 46. Inicialet e Nolte aktor.
- 47. Eshhtë tokë që... fitohet.
- 48. Një... gjermane.

VERTIKAL


- 1. Një votë në favor.
- 2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- 3. Në hyrje makinës.
- 4. Fillojnë lehtë.
- 5. Irlanda në Dublin.
- 6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
- 7. Një pjesë e gamiljeve
- 8. Notat pa kufij.
- 9. Ishin komitë.
- 10. Ka kryeqytet Islamabad.
- 12. Don... i Interpretuar nga Terence
- 13. Mbyllin aktet.
- 15. Janë përmasa.
- 18. Gjysma e lufjes.
- 19. Castellitto aktor.
- 20. Inicilat e Dalí, piktor.
- 21. Tanita këngëtare.
- 23. Eshhtë trysni
- 24. Në hyrje të Europës.
- 25. Janë rrobat për t'u larë.
- 30. Bën mëza.
- 31. Moreau aktore.
- 32. Janë thika.
- 39. Një pjesë e satelitit.
- 40. Janë teke në sende.
- 41. Pak marramendëse.
- 42. I ka tek zdapi.
- 45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

3			4	8				9
2	6	8					4	
		1						2
1	2	3			4	5	7	
4		5		3	6			
			2			3		4
	9		6	1			3	
7			8	5		2		1
8			7					

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	4	8	2	7	3	6	9	5
9	7	3	6	5	1	4	8	2
2	5	6	8	9	4	3	1	7
8	2	4	9	1	5	7	6	3
5	6	9	3	2	7	8	4	1
3	1	7	4	6	8	5	2	9
4	8	5	1	3	2	9	7	6
6	3	2	7	8	9	1	5	4
7	9	1	5	4	6	2	3	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Para së gjithash, armatosu.
- Përfitimet duhet të jepen gradualisht, dhe në këtë mënyrë ato do të shijohen më mirë.
- Sipërmarrësit janë thjesht ata që e kuptojnë se ka pak ndryshim mes pengesë dhe mundësisë. Dhe janë në gjendje t'i kthejnë të dyja në avantazhin e tyre.
- Urrejia është fituar me anë të veprave të mira aq shumë sa me anë të veprave të këqija
- Ai që dëshiron të jetë i bindur duhet të dijë se si të komandojë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5		
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18			5	11	2	6	5	8	2	6
8	2	6	2		2		1	8	5	11	1	
1	6	8		17	9	5	7	2			9	
3	1	5		8	2	16		2	7	1		
2				3	2	6	5	9	2		13	
6	2	7	2			3	7	18	18	18	6	1
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		

- Nëse duhet bërë një lëndim ndaj një njeriu, atëherë ai lëndim duhet të jetë shumë i rëndë saqë nga hakmarrja e tij të mos kesh aspak frikë.
- Eshhtë kënaqësi e dyfishit të mashtrosh mashtruesin.

Thënie të mençura

- Kështu del se pothuaj që të gjithë Profetët e armatosur kanë qenë fitimtarë, dhe të gjithë profetët e paarmatosur janë shkatërruar.
- Unë nuk jam i interesuar në ruajtjen e status quo-së, unë dua ta shkatëroj atë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I			
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R		
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O			
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N			
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T			
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K		
R	O	N	A	L	D	O	T	I	G	A	E		
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T	O	R		
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O	R		
I	R	O	N	A	C	E	M	Y					
L	O	T	R	I	K	E	P	A	R	O	D	I	A
L	O	T	R	A	C	O	R	O	T	K	N		
F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A		
A	D	A	M	P	A	L	T	M	I	N			
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	T			
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M	I	
N	M	A	R	T	A	R	I	L	E				
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E			
A	P	R	I	F	D	E	N	T	S	T			
C	I	T	A	T	E	M	E	T	O	R	E		
O	S	Z	P	A	M	T	R	E	T				
S	H	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A		
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R	I		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

